



# **Takimet në Graçanicë: Liderët komunalë dhe religjiozë**

**Shtator – Tetor 2024**

*Përgatitur nga:*

*Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)*

*Major Mehmet Bushi, H. III/1,  
10 000 Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +383 (0)38 542 778  
Web-site: [www.kipred.org](http://www.kipred.org)  
Email: [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org)*

*OJQ AKTIV*

*Kralja Petra I, 183a, Mitrovica,  
Kosovo.  
Tel: +381 (0) 64 310 6660  
Web-site: [www.ngoaktiv.org](http://www.ngoaktiv.org)  
Email: [office@ngoaktiv.org](mailto:office@ngoaktiv.org)*

*Përkrahur nga:*



---

*Informata në këtë botim është dhënë si pjesë e projektit “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë,” i zbatuar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) në partneritet me OJQ-në AKTIV dhe i financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky synon ta ofrojë një pasqyrë të rezultateve dhe të diskutimeve nga dialogjet multi-etnike në Graçanicë. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura këtu janë ato të pjesëmarrësve, dhe nuk i pasqyrojnë detyrimisht politikat dhe qëndrimet zyrtare të KFOS-it.*

## Parathënie

Nisma e shoqërisë civile “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” i përfshin 10 përfaqësues nga komunitetet e shoqërive civile shqiptare dhe serbe, të udhëhequr nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me seli në Prishtinë, dhe OJQ-ja AKTIV me seli në Mitrovicën e Veriut. Kjo nismë është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” synon ta forcojë dialogun, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, dhe t’i kontribuojë bashkëjetesës ndër-etnike në Kosovë.

Një aspekt i veçantë i kësaj nisme janë “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve,” të shkruara nga pjesëmarrësit e Karvanit. Këto letra i shprehin shpresat dhe vizionet e tyre për bashkëjetesë dhe respektim të ndërsjellë midis grupeve të ndryshme etnike. Këto shërbejnë si një bazë për diskutimet tona me kryetarët e komunave dhe me udhëheqësit fetarë, dhe po ashtu i përfshijnë edhe sugjerimet për përmirësimin e marrëdhënieve dhe për bashkëjetesën midis komuniteteve etnike.

Ju ftojme t’i përkrahni qëllimet e kësaj nisme për forcimin e themeleve dhe ndërtimin e një shoqërie multi-etnike, demokratike dhe liberale në Kosovë.

*Lulzim Peci*  
*Drejtor Ekzekutiv*  
*KIPRED*

*Miodrag Miličević*  
*Drejtor Ekzekutiv*  
*OJQ AKTIV*

## **Përmbajtja:**

<b>I. Hyrje .....</b>	<b>4</b>
Çështjet kyçe në takimin me Nën-Kryetarin e Komunës së Graçanicës .....	5
Çështjet kyçe në takimet me udhëheqësit fetarë .....	6
<b>II. Përfundimet dhe përkushtimet për veprimet e ardhshme .....</b>	<b>11</b>
<b>III. Letrat e Pritjeve dhe të Dëshirave .....</b>	<b>13</b>
Prof. Dr. Ljiljana Šubarić, Kryetare e Komunës së Graçanicës .....	13
Peshkopi Teodosije, Eparkia e Rashkës-Prizrenit e Kishës Ortodokse Serbe .....	27
Imami Xheladin Ef. Fazliu, Bashkësia Islame.....	40

# I. Hyrje

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” është një nismë risimtare e shoqërisë civile e jetësuar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe OJQ-ja AKTIV, që përkrahet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Me selitë operationale në Prishtinë dhe në Mitrovicën e Veriut, këto organizata e kanë udhëhequr një grup prej dhjetë përfaqësuesish, si nga komuniteti shqiptar, ashtu edhe nga ai serb.

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” synon t’i adresojë tendosjet ndëretnike të rrënjosura thellë në Kosovë, dhe atë kryesisht ato midis komunitetit shqiptar dhe atij serb, që kanë vazhduar për shkak të konflikteve historike, sfidave politike, dhe dallimeve kulturore e fetare. Këto tendosje i kanë penguar përpjekjet drejt pajtimit dhe bashkëjetesës, dhe janë përkeqësuar nga mundësitë e kufizuara për ndonjë dialog dhe ndërveprim domethënës midis komuniteteve. Qëllimi kryesor i projektit është ta forcojë një mjedis të qëndrueshëm të mirëkuptimit, respektimit, dhe bashkëpunimit të ndërsjellë midis komuniteteve shqiptare dhe serbe në Kosovë, përmes një dialogu risimtar dhe strategjive të angazhimit aktiv.

Për ta arritur këtë, projekti e ka caktuar një grumbull detyrash të veçanta, duke përfshirë:

1. Promovimin e Dialogut Ndëretnik: Ngritja e platformave të reja për dialog midis komuniteteve, që e shfrytëzojnë bashkëpunimin midis OJQ-ve, autoriteteve komunale, dhe udhëheqësive fetare për t’i tejkaluar ndarjet dhe për ta kultivuar multietnicitetin.
2. Forcimi i Mirëkuptimit Ndëretnik: Rritja e besimit dhe e dashamirësisë së ndërsjellë midis komuniteteve duke u përballur me stereotipet dhe keqkuptimet, dhe duke e promovuar respektimin dhe vullnetin e mirë.
3. Të Ndihmuarit e Bashkëpunimit: Inkurajimi i nismave të përbashkëta dhe i veprimtarive bashkëpunuese ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, qeverisjeve lokale, dhe udhëheqësve fetarë përmes vijave etnike për të punuar drejt qëllimeve të përbashkëta për përmirësimin e gjendjes së komuniteteve dhe për ndryshimin shoqëror në Kosovë.

Përmes përmbushjes së këtyre qëllimeve, projekti përpigjet, jo vetëm t’i zbusë tendosjet e tashme, por edhe t’i shtrojë themelet për një shoqëri paqësore dhe kohezive multi-etnike, duke i kontribuar qëllimit më të gjerë të paqes dhe të stabilitetit në rajon si dhe integriteteve evropiane.

Si ndalesë e dytë në udhëtimin e Karvanit, Graçanica – komuna më e madhe me shumicë serbe në Kosovën qendrore dhe jugore – ua ka ofruar një mundësi anëtarëve të vet për t’u angazhuar me udhëheqës komunalë dhe fetarë me ndikim. Këta e përfshinin Zëvendës Kryetarin e Komunës së Graçanicës, z. Leutrim Ajetin, dhe Këshilltarin e Kryetarit të Komunës, z. Saša Denićin, si dhe Peshkopin Teodosije të Eparkisë së Rashkës–Prizrenit të Kishës Ortodokse Serbe, dhe përfaqësuesin lokal të Bashkësisë Islame, Imamin Xheladin ef. Fazliun. Takimet u bënë më 13 shtator dhe 21 tetor 2024. Kryetarja e Graçanicës, Dr. Liljana Šubarić mungoi nga takimi për shkak të obligimeve të pashmangshme dhe një angazhimi emergjent.

Qendrore në këtë ndërmarrje janë “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve,” që iu drejtuan bashkëbiseduesve kyç në Graçanicë: Kryetares së Komunës, Liljana Šubarić, Peshkopit Teodosije të Eparkisë së Rashkës–Prizrenit të Kishës Ortodokse Serbe dhe përfaqësuesit lokal të Bashkësisë Islame, Imamit Xheladin ef. Fazliu, të cilat janë përpiluar me mençuri nga pjesëmarrësit e karvanit. Këto letra janë më shumë se thjesht formalitete; ato i mishërojnë shpresat dhe vizionet e singerta të autorëve të tyre për një të ardhme ku grupet e ndryshme etnike jetojnë bashkë në paqe dhe respektim. Letrat janë themelore për procesin e dialogut, duke i udhëhequr diskutimet me

kryetarët e komunave dhe me udhëheqësit fetarë. Këto përmbajnë sugjerime të menduara thellë që e synojnë përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe të ndihmuarit e bashkëjetesës së përditshme midis komuniteteve.

Teksti në vijim i përvijon përfundimet kyçe që janë nxjerrë nga këto diskutime të rëndësishme, si dhe letrat që i shprehin aspiratat dhe pritjet që i ndajnë anëtarët e Karvanit.

## **Pikat kyçe nga takimi në Zyren e Kryetares së Komunës së Graçanicës**

Takimi me udhëheqësinë e Komunës së Graçanicës, 13 shtator 2024. Përmes letrave të dëshirave dhe pritjeve, anëtarët e Karvanit e shprehën dëshirën e tyre për një rol më të madh të komunës së Graçanicës në përparimin e multi-etnicitetit dhe të tolerancës, dhe parashtruan për shqyrtim propozime konkrete.

Propozimet kyçe nga letrat e dëshirave dhe të pritjeve që iu drejtuan Kryetares së Komunës:

- Të punohet për politika që adresojnë diskriminimin dhe sigurojnë një qasje të barabartë për të gjitha grupet etnike. Zbatimi dhe përkrahja e mekanizmave legalë për t'i mbikëqyrur dhe për të reaguar ndaj rasteve të dhunës etnike apo diskriminimit do ta sigurojnë paanësinë dhe mbrojtjen e të gjithë qytetarëve. Promovimi i bashkëpunimit ekonomik midis komuniteteve të ndryshme etnike përmes ndërmarrjeve të përbashkëta të biznesit dhe krijimit të platformave të tilla si tregjet lokale për tregti dhe bashkëpunim, jo vetëm që do t'i fuqizojnë ekonominë lokale, por po ashtu edhe do ta zhvillojnë ndjenjën e bashkëjetesës.
- Zhvillimi i programeve që e theksojnë rëndësinë e diversitetit dhe të bashkëpunimit duke siguruar që të gjithë qytetarët të ndjehen të vlerësuar dhe të përfshirë. Themelimi i mbledhjeve këshilluese me përfaqësuesit nga grupet e ndryshme etnike mund të jetë një hap domethënës drejt sigurimit që çdo zë të dëgjohet dhe të merret parasysh.
- Të vazhdohen përpjekjet që: a) Të forcohet udhëheqja komunale duke i përkrahur nismat që i fuqizojnë pjesëtarët e komuniteteve etnike për të marrë pjesë aktivisht në proceset vendim-marrëse. b) Të promovohen përpjekjet paqeruajtëse në bazë përmes organizatave dhe nismave lokale. c) Të inkurajohet bashkëpunimi ndëretnik në nivelin lokal për t'i adresuar sfidat dhe mundësitë e përbashkëta. d) Të avokohet për përfshirjen e këndvështrimeve komunale në politikë-bërjen rajonale dhe kombëtare. e) Të udhëhiqet përmes shembullit duke demonstruar përkushtimin ndaj tolerancës, mirëkuptimit dhe respektimit të diversitetit në vetë veprimet dhe politikat tona.
- Të udhëhiqen përpjekjet për ta ndërtuar një komunitet tolerues dhe përfshirës duke u angazhuar aktivisht, si me banorët serbë, ashtu edhe me ata shqiptarë, duke i përkrahur nismat që e forcojnë dialogun, dhe duke siguruar që politikat lokale i pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e të gjitha grupeve etnike.
- Të hetohen shtigjet për rritjen e ndërveprimit ndërkomunal, mundësisht përmes: a) Takimeve të rregullta me Kryetarin e Komunës së Prishtinës, ashtu që të diskutohen projektet reciprokisht fitimprurëse, që përfshijnë planifikimin dhe jetësimin e përbashkët për një lidhje më të madhe të projekteve të përbashkëta ekonomike midis Graçanicës dhe Prishtinës; b) Themelimit të mundshëm të Qendrës Rinore Multi-Etnike për rininë e Prishtinës dhe Graçanicës, si një hapësirë e sigurtë për të rinjtë që të takohen dhe të njihen me njëri-tjetrin. Kjo Qendër mund të shërbejë po ashtu edhe si një hapësirë për art, kulturë dhe për takimin e specialistëve të IT-së – fusha këto ku të rinjtë janë me më së

shumti gjasë të bashkëpunojnë; c) Promovimit të përbashkët të mirëkuptimit multi-etnik dhe ndërfaqet nga Graçanica dhe Prishtina, përfshirë një ngjarje simbolike vjetore të organizuar bashkarisht nga dy komunat.

- Hetimi i mundësisë që në shkollat e Graçanicës të organizohen ngjarje që e krenojnë diversitetin e Kosovës. Këto ngjarje mund t'i edukojnë nxënësit për grupet e ndryshme etnike dhe kulturat e tyre në Kosovë, me organizatat e shoqërisë civile që u ndihmojnë në planifikimin dhe ekzekutimin e këtyre veprimtarive. Vendosija e një theksi më të madh në funksionalitetin e Komiteteve Komunale për Komunitete.
- Të hetohet themelimi i qendrave ndër-kulturore dhe nismave që promovojnë dialog dhe projekte të përbashkëta të komunitetit, për shembull duke themeluar një "Këshill të Bashkëjetesës."
- Të hetohet themelimi i punëtorive, i programeve të shkëmbimit kulturor, dhe i veprimtarive edukative që e krenojnë traditën e gjatë të shekullit tonë të multietnicitetit; Organizimi i festivaleve që i shfaqin traditat e pasura të grupeve të ndryshme etnike mund ta ndihmojë krenimin e diversitetit lokal, ndërkohë që e promovon ndjenjën e përkatësisë, si dhe promovimin e mundësive të njëjta ekonomike për të gjithë banorët e vet; Përkrahja e bizneseve lokale, posaçërisht e atyre që e përvetësojnë diversitetin në fuqinë e tyre punëtore.

Zëvendës Kryetari i Komunës, z. Ajeti, dhe Këshilltari i Kryetares së Komunës, z. Denić, e shprehën një përkrahje të fuqishme për nismën, duke e bërë të ditur rëndësinë e saj dhe përkushtimin e tyre për bashkëpunim. Ata i ndanë njohuritë për bashkëpunimin e suksesshëm ndëretnik brenda Graçanicës, duke theksuar komunën si një model të harmonisë në Kosovë. Ata i nënvizuan në veçanti përpjekjet e Komunës për t'i përfshirë zgjidhjet e mospajttimeve ndër-etnike në mënyrë efektive dhe për të qenë nikoqire e ngjarjeve kulturore si iftari i ndjekur, si nga anëtarët e komunitetit mysliman, ashtu edhe nga ata të komunitetit ortodoks. Për më tepër, Komuna vitin e kaluar e kishte organizuar iftarin për nder të komunitetit islam të Graçanicës.

Përfaqësuesit dhanë hollësi të veprimtarive të ndryshme të orientuara kah komuniteti në Graçanicë, të tilla si një kamp edukativ në Brezovicë që e mirëpret rininë e të gjitha etnive, dhe veprimtaritë rekreative të përpiluara për gra përmes komuniteteve të ndryshme. Këto nisma e nënvizojnë përkushtimin e komunës për forcimin dhe mirëpritjen e një mjedisi përfshirës.

Që të dy zyrtarët komunalë u pajtuan për rëndësinë e të qenit më të zëshëm për këta shembuj pozitivë të bashkëpunimit multietnik. Ata e nënvizuan nevojën për t'i theksuar dhe krenuar këto përpjekje në mënyrë publike për ta frymëzuar integrimin dhe ndërtimin e mëtutjeshëm të paqes anëmbanë Kosovës.

### **Pikat kyçe nga takimet me udhëheqësit fetarë**

Pikat kyçe nga letrat e pritjeve dhe dëshirave që u janë adresuar udhëheqësve fetarë ishin të përqendruara përgjatë vijave të avokimit të mëtutjeshëm të mirëkuptimit dhe të bashkekzistencës midis komuniteteve etnike, përfshirë edhe veprimtaritë e përbashkëta. Propozimet kyçe të letrave ishin si në vijim:

*Për Dioqezën Rashkë-Prizren të Kishës Ortodokse Serbe:*

- Të vazhdohet përkrahja e programeve të komunitetit që i bëjnë bashkë njerëzit e prapavijave të ndryshme, duke i promovuar veprimtaritë e përbashkëta dhe shkëmbimet

ndërkulturore. Predikimet dhe mesazhet publike mund t'i theksojnë edhe më tutje rëndësinë e unitetit, të tolerancës, dhe të respektimit të të gjithëve, pavarësisht nga prapavijat e tyre etnike dhe fetare.

- Të shqyrtohen veprimet e veçanta vijuese për ta ndihmuar pajtimin dhe integrimin: a) Organizimi dhe përkrahja e dialogjeve ndër-fetare dhe e ngjarjeve për promovimin e mirëkuptimit dhe të respektimit midis komuniteteve të ndryshme fetare. b) Ofrimi i resurseve edukative dhe i trajnimit për udhëheqësit fetarë dhe anëtarët e komunitetit për tema të tilla si zgjidhja e konflikteve, të drejtat e njeriut, dhe komunikimi ndërkulturore. c) Nismat përkrahëse që e promovojnë kohezionin shoqëror dhe pjesëmarrjen qytetare në mesin e të gjitha grupeve etnike në Kosovë. d) Ngritja e zërit kundër diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, dhe dhunës kundër çfarëdo komuniteti. e) Inkurajimi i pjesëmarrjes së të rinjve në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe pajtim.
- Inkurajimi i klerit dhe i kongregacioneve për t'u angazhuar në dialogun ndër-etnik, përkrahja e nismave për paqe, dhe mbrojtja e politikave që e promovojnë barazinë dhe drejtësinë për të gjitha grupet etnike.
- Hetimi i shtigjeve për themelimin e një këshilli ndër-fetar me institucionet e tjera fetare.
- Inkurajimi i Dialogut Ndërfetar dhe Ndëretnik; Promovimi i Vlerave të Përbashkëta të Dashamirësisë dhe Paqes; Përkrahja e Angazhimeve Rinore në Ndërtimin e Paqes; Bashkëpunimi në Projektet e Komunitetit.

Takimi me Peshkopin Teodosije – Manastiri i Graçanicës – 21 tetor 2024. Peshkopi Teodosije e hapi bisedën duke i përmendur lidhjet e tij të thella personale me rajonin, më në veçanti me vendet e manastireve të Deçanit dhe të Graçanicës, të cilat e tërheqin një numër të madh vizitorësh për shërbimet liturgjike. Kjo dyndje e vizitorëve, vërejt ai, e nënvizon jehonën e thellë shpirtërore që këto vende e kanë për njerëzit përtej ndarjeve etnike dhe fetare.

Ai i lavdëroi përpjekjet e Karvanit, duke e theksuar rëndësinë e kësaj nisme për rritjen e një shoqërie multi-etnike në Kosovë, dhe e ofroi përkrahjen e tij të plotë.

Peshkopi Teodosije i shprehu shqetësimet për dinamikën e marrëdhënieve ndër-fetare, duke i përkujtuar rastet ku ndjenjat nacionaliste e lanë në hije unitetin shpirtëror, ngjashëm me përvojat e tij në Kroaci. Ai i diskutoi sfidat me të cilat përballet komuniteti serb në ruajtjen e pranisë së vet në vende të ndryshme në Kosovë, të tilla si Hoça e Madhe, Gorazhdevci, dhe posaçërisht Graçanica, ku ndryshimet demografike parashtrajnë shndërrime potenciale kulturore dhe shoqërore. Një temë prekëse e ngritur nga ai ishte politizimi i vendndodhjeve fetare dhe pasaktësitë me të cilat përballemi gjatë përcaktimit zyrtar të pronave të kishës, e të cilat kanë çuar në keqinterpretime publike të trashëgimisë së tyre.

Një çështje e veçantë u ngrit nga Karvani – ajo e pronësisë së Kishës Ortodokse Serbe në Prishtinë që është duke u përdorur nga Agjencia Anti-Korrupsion e Kosovës, e cila nuk është duke ia paguar qiranë Kishës që nga viti 2019. Peshkopi informoi anëtarët që lidhur me këtë çështje nuk është bërë kurrfarë përparimi.

Edhe përkundrejt këtyre sfidave, Peshkopi Teodosije e theksoi misionin e Kishës të dashurisë dhe të shërbimit të pakushtëzuar, duke i bërë jehonë ndjenjës se “Dashuria është dashuri vetëm nëse nuk kërkon asgjë në shkëmbim,” dhe duke e nënvizuar përkushtimin e vet ndaj shërbimit të komunitetit përtej vijave etnike dhe fetare.

Diskutimi përfundoi me njohjen e ndërsjellë të peisazhit kompleks socio-politik që e ndikon Kosovën. Peshkopi Teodosije dhe anëtarët e shoqërisë civile i bënë të ditura vështirësitë, por



megjithatë edhe e rikonfirmuan përkushtimin e tyre për t'i tejkaluar ato përmes dialogut të vazhdueshëm dhe përpjekjeve bashkëpunuese që synojnë forcimin e një shoqërie paqësore dhe kohezive multi-etnike. Ky takim e theksoi përkushtimin kolektiv në orientimin e sfidave dhe në punën drejt një mjedis harmonik të komunitetit në Kosovë, dhe përfundoi me një marrëveshje për t'i vazhduar takimet.

#### *Për Komunitetin Lokal Islamik*

- Të ofrohet udhëzimi që i thekson vlerat si paqja, falja dhe respektimi i ndërsjellë, duke i trajtësuar në këtë mënyrë qëndrimet dhe sjelljet, si të besimtarëve, ashtu edhe të komunitetit më të gjerë; të barten mesazhet e tolerancës dhe të paqes, duke i inkurajuar vijuesit për t'i përqafuar këto vlera si thelbësore për bashkekzistencën tonë; duke e edukuar komunitetin dhe duke e frymëzuar rininë për rëndësinë e bashkekzistencës dhe respektimin e diversitetit, ky komunitet mund ta luaj një rol jetik në trajtësimin e një shoqërie më harmonike dhe më përfshirëse.
- Të kontribuohet për t'i tejkaluar ndasitë dhe për t'i forcuar marrëdhëniet paqësore midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare.
- Të promovohet dialogu dhe mirëkuptimi ndërfetar, të flitet kundër diskriminimit, kundër gjuhës së urrejtjes, dhe dhunës ndaj çdo komuniteti, pavarësisht nga besimet e tyre fetare, të përkrahen nismat që e promovojnë kohezionin shoqëror dhe pjesëmarrjen qytetare në mesin e të gjitha grupeve etnike dhe fetare në Graçanicë, dhe të inkurajohet përfshirja e të rinjve në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe të pajtimit.
- Aktivitetet e veçanta që mund të ndërmerren për ta përkrahur dialogun ndërfetar dhe tolerancën përfshijnë: Organizimin e mbledhjeve të përbashkëta të komuniteteve fetare për ta promovuar unitetin dhe mirëkuptimin; Themelimin dhe përkrahjen e forumeve për dialogun ndërfetar për ta ofruar platformën për një diskutim të hapur dhe të respektueshëm; Përkrahjen e nismave të bazuara në komunitet që e promovojnë bashkëpunimin ndërfetar.
- Të vazhdohet udhëheqja e përpjekjeve për ta ndërtuar një komunitet paqësor dhe përfshirës duke e inkurajuar dialogun ndëretnik, të përkrahen nismat që e promovojnë mirëkuptimin dhe të mbështeten mundësitë e barabarta për të gjitha grupet etnike.
- Të ndihmohet përfshirja e respektimit për diversitetin fetar dhe etnik në predikimet e Xhumasë.
- Brenda xhamive të jetësohen mësimet që përkrahin mirëkuptimin dhe bashkëjetesën ndëretnike dhe ndërfetare.

Takimi me z. Xheladin ef. Fazliun, Imamin e Bashkësisë lokale Islame – Xhamia e Hajvalisë, 13 shtator, 2024. Në takim Imam Fazliu e theksoi rolin kritik të udhëheqësve fetarë në forcimin e kohezionit të komunitetit. Gjatë takimit, Imamin Fazliu iu dhanë Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve.

Imam iFazliu shprehu vlerësimin e tij për këtë nismë ndëretnike, duke i përmendur marrëdhëniet historikisht pozitive midis komuniteteve etnike në Komunën e Graçanicës. Ai vërejti mungesën e përplasjeve ndëretnike brenda komunës dhe foli për bashkëpunimin në rrjedhje e sipër me Kishën Ortodokse Serbe. Imami Fazliu nënvizoi që udhëheqësit fetarë të besimeve të ndryshme rregullisht ftohen në festat fetare dhe ngjarjet e rëndësishme të njëri-tjetrit, duke e ushqyer kështu frymën e mirëkuptimit dhe të respektimit të ndërsjellë.

Imami Fazliu i lavdëroi përpjekjet e udhëheqësisë së Komunës së Graçanicës, duke bërë të ditur udhëheqjen e tyre efektive në ruajtjen e paqes dhe të bashkëjetesës brenda komunitetit. Ai po ashtu përmendi se bizneset bashkëpunuese në pronësi të individëve të prapavijave të ndryshme etnike lulëzojnë, duke i kontribuar kështu bashkëzistencës paqësore.

Imami Fazliu përsëriti përkushtimin e tij për përkrahjen e qëllimeve të Karvanit dhe shprehu vullnetin e tij për të marrë pjesë aktive në përpjekjet e ardhshme për ta rritur bashkëjetesën ndëretnike. Ai e theksoi rëndësinë e vazhimit të këtyre përpjekjeve për ta siguruar një mjedis paqësor dhe përfshirës për të gjithë banorët e Kosovës.

## II. Përfundimet dhe përkushtimet për veprimet e ardhshme

### Roli i Udhëheqjes Komunale në Rritjen e Kohezionit të Komunitetit:

#### Përfundimet:

1. **Përkrahja për përpjekjet multi-etnike:** Udhëheqësit e Komunës së Graçanicës kanë treguar një përkrahje të fuqishme për nismën e Karvanit, duke e njohur rëndësinë e tij në promovimin e bashkëzistencës multi-etnike. Ata e nënvizuan komunën e tyre si një model të harmonisë në Kosovë, me një përkushtim të dëshmuar për zgjidhjen e mospajtimeve ndëretnike dhe për mikpritjen e ngjarjeve kulturore përfshirëse.
2. **Nismat e suksesshme të komunitetit:** Përpjekjet e Komunës për organizimin e veprimtarive të përbashkëta, të tilla si iftari për të dy komunitetet, si atë mysliman, ashtu edhe për atë ortodoks, dhe kampi edukativ në Brezovicë, e japin shembullin e përkushtimit të tyre për forcimin e një mjedis multi-etnik. Këto nisma i kanë kontribuar mbajtjes së paqes dhe promovimit të respektimit të ndërsjellë në mesin e komuniteteve të ndryshme.
3. **Publikimi i shembujve pozitivë:** Komuna e kupton nevojën për t'i theksuar këto nisma pozitive për t'i frymëzuar rajonet e tjera në Kosovë dhe përtej. Ata e pranojnë rëndësinë e tregimit të përmbushjeve të tyre si një mjet për ta inkurajuar një pranim më të gjerë dhe përvetësim të praktikave të ngjashme.

#### Përkushtimet për të ardhmen:

1. **Bashkëpunimi në rrjedhje e sipër me Karvanin:** Zyra e Kryetares së Komunës është e përkushtuar për ta vazhduar përkrahjen e vet për aktivitetet e Karvanit, duke punuar nga afër me të gjithë hisenikët për ta promovuar bashkëpunimin multi-etnik në komunë.
2. **Promovimi i modeleve pozitive të bashkëzistencës:** Komuna do të ndër marrë hapa aktivë për t'i përkrahur publikisht shembujt pozitivë të bashkëpunimit ndëretnik në Graçanicë, duke i përfshirë këtu fushatat në media, forumet publike, dhe ngjarjet në komunitet, për t'i frymëzuar të tjerët që t'i përsërisin këto përpjekje.
3. **Zgjerimi i nismave të orientuara kah komuniteti:** Komuna e Graçanicës është e përkushtuar që t'i zhvillojë më tutje veprimtaritë e orientuara kah komuniteti, duke siguruar që nismat e mëtutjeshme do të mbeten përfshirëse dhe do t'i bëjnë bashkë grupet e ndryshme etnike, dhe posaçërisht përmes ngjarjeve të përbashkëta kulturore, edukative dhe rekreative.

## **Përkushtimet nga Udhëheqësit Fetarë**

### **Peshkopi Teodosije**

#### **Përfundimet:**

1. **Përkrahja për Paqe-Ndërtimin Multi-Etnik:** Peshkopi Teodosije shprehu përkrahje të fuqishme për përpjekjet e Karvanit për ta promovuar shoqërinë multi-etnike në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e rritjes së bashkekzistencës përmes respektimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Ai i lavdëroi nismat e Karvanit si jetike për ushqimin e unitetit në peisazhin kompleks socio-politik të Kosovës.
2. **Sfidat e Marrëdhënieve Ndërfetare dhe Ndëretnike:** Edhe përkundrejt përkrahjes pozitive, Peshkopi Teodosije ngriti shqetësimet e veta për sfidat me të cilat përballet Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë, përfshirë këtu ndryshimet demografike, politizimin e vendeve fetare, dhe çështjet e pazgjidhura pronësore, të cilat i pengojnë përpjekjet për integrimin e plotë dhe për bashkekzistencën paqësore.
3. **Shërbimi përtej vijave etnike:** Peshkopi nënvizoi rëndësinë e dashurisë dhe të shërbimit të pakushtëzuar për të gjitha komunitetet, duke e përsëritur rolin e Kishës në forcimin e paqes dhe të bashkëpunimit përmes ndarjeve etnike dhe fetare.

#### **Përkushtimet për të Ardhmen:**

1. **Përkrahja e vazhdueshme për Karvanin:** Peshkopi Teodosije e përsëriti përkrahjen e vet të plotë për përpjekjet e Karvanit, duke e marrë përsipër që të angazhohet në mënyrë aktive në nismat e tij dhe në promovimin e vlerave të bashkëpunimit ndërfetar dhe ndëretnik.
2. **Adresimi i çështjeve pronësore dhe i atyre të vendeve fetare:** Peshkopi u përkushtua për vazhdimin e dialogut me autoritetet relevante për t'i adresuar sfidat që kanë të bëjnë me pronat e Kishës, me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe për ta siguruar mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë fetare.
3. **Promovimi i unitetit dhe paqes:** Peshkopi Teodosije do të vazhdojë ta shfrytëzojë ndikimin e vet për t'i promovuar mesazhet e paqes, duke i inkurajuar udhëheqësit e tjerë fetarë dhe të komunitetit që të bashkëpunojnë për një shoqëri harmonike dhe përfshirëse në Kosovë.

### **Imami Fazliu**

#### **Përfundimet:**

1. **Përkrahja për qëllimet e karvanit:** Imami Fazliu e shprehu vlerësimin e qëllimeve të Karvanit, duke e theksuar rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndëretnik, posaçërisht përmes udhëheqësisë së Komunës së Graçanicës dhe bashkëpunimit të rregullt midis komuniteteve fetare. Përkrahja e tij për misionin e Karvanit e thekson përkushtimin e tij për paqe dhe bashkekzistencë.
2. **Historia e fuqishme e bashkëpunimit:** Imami Fazliu i nënvizoi marrëdhëniet e gjata pozitive midis komuniteteve etnike në Graçanicë dhe rolin aktiv të udhëheqësve fetarë në promovimin e unitetit. Ai e lavdëroi respektin e ndërsjellë të dëshmuar nga komunitetet e ndryshme fetare, dhe posaçërisht përmes pjesëmarrjes së përbashkët në ngjarjet fetare dhe kulturore.
3. **Përkushtimi ndaj ndërtimit të paqes:** Imami Fazliu e theksoi rolin kritik të udhëheqësve fetarë në forcimin e paqes, duke përsëritur që bashkëpunimi midis

besimeve të ndryshme është kyç për ruajtjen e mjedisit paqësor dhe përfshirës për të gjithë banorët e Kosovës.

**Përkushtimet për të Ardhmen:**

1. **Pjesëmarrja e vazhdueshme aktive:** Bashkësia Islame në Graçanicë është e përkushtuar për pjesëmarrjen aktive në ngjarjet e Karvanit në të ardhmen, përfshirë dialogjet ndërfaqetare dhe aktivitetet e përbashkëta që synojnë rritjen e bashkekzistencës multi-etnike dhe forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë.
2. **Forcimi i bashkëpunimit fetar:** Bashkësia Islame në Graçanicë do të vazhdojë ta forcojë bashkëpunimin midis komuniteteve fetare, duke i ftuar udhëheqësit e besimeve të ndryshme për të marrë pjesë në ngjarjet e njëri-tjetrit dhe duke e forcuar një mjedis të respektimit dhe të mirëkuptimit të përbashkët.
3. **Përkrahja e paqes dhe e bashkëjetesës:** Bashkësia Islame në Graçanicë do ta përkrahë vazhdimin dhe zgjerimin e nismave që e promovojnë paqen dhe bashkekzistencën, si brenda Graçanicës, ashtu edhe në të tërë Kosovën, duke siguruar që këto përpjekje të jenë të qëndrueshme dhe të përkrahura nga të gjitha komunitetet fetare.

## Takimet në Graçanicë: Nënkryetari i Komunës dhe Liderët Fetarë



Takimi me z. Leutrim Ajeti,  
Nënkryetar i Komunës së Graçanicës  
13 shtator, 2024



Takimi me Hirësinë e Tij, Peshkopin  
Teodosije të Eparkisë së Kishës Ortodokse  
Serbe Rashkë-Prizren  
21 tetor, 2024



Takimi me Imam Xheladin ef Fazliu,  
Hajvali  
13 shtator, 2024



## Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Šabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Prof. Dr. Ljiljana Šubarić  
Kryetare e Komunës së Graçanicës

Tetor 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive  
Instituti i Prishtinës për Studime Politike  
Prishtinë, Kosovë**

E dashura Kryetare Dr. Šubarić,

Quhem Leonora Kryeziu, dhe jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, projekt ky i nisur nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Jam Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS – Prishtina Institute for Political Studies), një think-tank në Prishtinë, i themeluar 22 vite më parë nën përkujdesin e Këshillit të Europës. Misioni jonë është ta promovojmë një kulturë të re politike në Kosovë, të rrënjosur në vlerat thelbësore të Kushtetutës sonë – lirisë, demokracisë, dhe paqes, dhe ta bëjmë Kosovën atdhe të gjithë qytetarëve të vet. Gjatë dy dekadave të kaluara karrierën time ia kam përkushtuar përparimit të këtyre parimeve demokratike dhe forcimit të kohezionit shoqëror në të tërë Kosovën. Mirëpo, përpjekjet tona janë duke u sfiduar gjithnjë e më shumë nga ndarjet gjithnjë e më të thella etnike, gjë kjo që e nënvizon nevojën urgjente për angazhim më të madh qytetar dhe për një qasje më proaktive në trajtimin e këtyre çështjeve. Në dritën e këtyre sfidave, i jam bashkuar Karvanit dhe një koalicioni tjetër të shoqërisë civile, Alternativës Qytetare Kosovare (KCA – Kosovo Civic Alternative), ku që të dyjat synojnë të japin kontribute konkrete për promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit ndëretnik.

Si anëtare e Karvanit, më është kërkuar që në këtë letër t'i trajtoj dëshirat dhe pritjet e mia lidhur me promovimin e paqes dhe të bashkëjetesës harmonike etnike në Kosovë.

Si Kryetare e Komunës, roli juaj në promovimin e bashkëjetesës multietnike është kyç. Duke qëndruar me vendosmëri për këtë kauzë, ju jo vetëm që do ta forconi strukturën sociale të komunitetit tuaj por po ashtu do ta jipni një shembull të fuqishëm për t'u ndjekur nga të tjerët. Në shoqëritë me prapavija etnike të shumëllojshme, udhëheqja që në mënyrë aktive e promovon përfshirjen, respektimin e ndërsjellë, dhe bashkëpunimin, e ushqen kulturën e mirëbesimit, i ul tendosjet, dhe e ndihmon ndërtimin e një të ardhmeje paqësore dhe kohezive. Përkushtimi juaj ndaj këtyre vlerave e rrit në një masë të madhe qëndrueshmërinë e komunitetit përballë sfidave dhe e krijon një mjedis më harmonik për të gjithë.

E pranoj që sot është jashtëzakonisht e vështirë të qëndrosh si një udhëheqës në një shoqëri thellësisht të ndarë përgjatë vijave etnike. Mirëpo, Komuna e Graçanicës e ka një situatë unike për t'u bërë model i bashkëjetesës paqësore dhe bashkëpunimit ndëretnik. Vendi i saj strategjik dhe trashëgimia e pasur kulturore asaj ia japin potencialin për të demonstruar se uniteti përgjatë vijave etnike, jo vetëm që është i mundshëm, por po ashtu është edhe fitimprurës për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik. Duke e përvetësuar këtë rol, Graçanica mund të shndërrohet në një pishtar të shpresës e të përparimit për komunat e tjera që përballen me sfida të ngjashme.

Për ta çuar këtë përpjekje më tutje, puna drejt politikave që e adresojnë diskriminimin dhe sigurojnë qasje të barabartë për të gjitha grupet etnike është jetike. Jetësimi dhe mbështetja e mekanizmave ligjorë për t'i mbikëqyrur dhe për të reaguar ndaj shembujve të dhunës etnike apo diskriminimit do ta sigurojnë drejtësinë dhe mbrojtjen për të gjithë qytetarët. Së dyti, promovimi i bashkëpunimit ekonomik midis komuniteteve të ndryshme etnike përmes ndërmarrjeve të përbashkëta të biznesit dhe krijimi i platformave të tilla si tregjet lokale për tregti dhe bashkëpunim, jo vetëm që do t'i forcojë ekonomitë lokale, por po ashtu do ta forcojë edhe ndjenjën e unitetit.

Pos kësaj, kujtimi i së kaluarës dhe rritja e pajtimit janë përbërës thelbësorë të shërimit. Duke i përkrahur nismat si memorialet, tryezat e rrumbullakëta, apo proceset e tregimit të së vërtetës

që i bëjnë të njohura konfliktet dhe traumat e kaluara, ju mund t'i ndihmoni komunitetet që të lëvizin drejt një të ardhmeje të rrënjosur në mirëkuptim dhe në shpresën e përbashkët. Për këto veprime, ju mund t'i përkrahni OJQ-të lokale që punojnë rreth këtyre çështjeve.

Ju falemnderit për kohën dhe vëmendjen tuaj për këto çështje. Shpresoj të takohemi personalisht.

Sinqerisht,

Leonora Kryeziu



**Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive**  
**New Social Initiative**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

E dashura Kryetare e Komunës, Šubarić,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Quhem Jovana Radosavljević, dhe jam aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, e përkushtuar për nxitjen e pajtimit midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karavanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë për t'i ndarë pritjet dhe shpresat e mia për bashkëjetesën multi-etnike në Kosovë dhe posaçërisht në Graçanicë.

Si Kryetare e Komunës, ndikimi juaj në udhëheqjen e Graçanicës drejt një të ardhmeje të harmonisë dhe të bashkëpunimit është vendimtar. Besoj që angazhimi juaj aktiv me qytetarët dhe vëmendja ndaj brengave të tyre është thelbësore në ndërtimin e besimit dhe të bashkëpunimit midis komuniteteve të ndryshme etnike. Ndërveprimet e rregullta me banorët, dialogjet e hapura, dhe adresimi i drejtpërdrejtë i brengave të tyre mund ta nxisë ndjenjën e sigurisë, të përfshirjes dhe të respektimit të ndërsjellë.

**Tolerimi dhe respektimi i të gjithë individëve, pavarësisht nga prapavija e tyre etnike, janë thelbësore për një shoqëri paqësore.** Ju inkurajoj t'i përkrahni nismat që i promovojnë këto vlera dhe që e lartësojnë diversitetin brenda Graçanicës. **Vlerësimi i lartë i diversitetit, ndërkohë që sigurohet që çdokush të ndjehet i sigurtë, i respektuar, dhe i mbrojtur,** do ta hapë rrugën për një komunitet më koheziv.

Duke shikuar përpara, vizioni im është i një Graçanice ku bashkëjetesa multi-etnike jo vetëm që është e mundshme, por edhe përqafohet në mënyrë aktive. Shpresoj ta shoh zhvillimin e programeve që e nënvizojnë rëndësinë e diversitetit dhe të bashkëpunimit, duke siguruar që të gjithë qytetarët të ndjehen të çmuar dhe të përfshirë. Themelimi i një kuvendi këshillues të qytetarëve me përfaqësues nga grupet e ndryshme etnike mund të jetë një hap domethënës për të siguruar që çdo zë do të dëgjohet dhe do të merret parasysh.

Në përfundim, ju nxis t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor, përfshirës, dhe tolerant. Udhëheqja juaj në këto fusha mund t'i frymëzojë të tjerët për ta ndihmuar krijimin e një të ardhmeje ku, si në Graçanicë, ashtu edhe në Kosovë, çdonjëri do të ndjehet i sigurtë, i respektuar, dhe në shtëpi të vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Jovana Radosavljević

**Dr. Robert Muharremi**  
**Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies**  
**Rochester Institute of Technology in Kosovo**  
**Prishtinë, Kosovë**

E dashura Profesoreshë Dr. Ljiljana Šubarić,

Quhem Robert Muharremi, dhe jam Drejtor i Qendrës për Studime të Paqes dhe Konfliktit në RIT në Kosovë. Jam duke ju shkruar për ta shprehur përkrahjen time të fuqishme për Karvanin Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një projekt ky i nisur nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Unë po ashtu e shpreh përkrahjen time të fuqishme për përpjekjet tuaja për ta promovuar pajtimin dhe integrimin midis komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike në Kosovë.

Jam duke ju shkruar për ta shprehur përkrahjen time të fuqishme për përpjekjet tuaja si Kryetare e Komunës së Graçanicës për ta promovuar pajtimin dhe integrimin midis komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë. Si një udhëheqëse e respektuar politike brenda komunitetit serb, roli juaj në forcimin e mjedisit paqësor dhe përfshirës është kyç. Besoj se duke i përkrahur nismat që e promovojnë mirëkuptimin, dialogun dhe bashkëpunimin, ju mund t'i kontribuoni në një mënyrë domethënëse stabilitetit dhe përparimit të përgjithshëm të Kosovës. Duke i fuqizuar komunitetet lokale serbe për t'i marrë përsipër përpjekjet paqe-ndërtuese, ne mund të sigurojmë që të ndodhë një ndryshim i qëndrueshëm dhe domethënës.

Do të doja t'ju inkurajoj për t'i vazhduar përpjekjet tuaja për:

- Ta nxitur udhëheqësinë lokale serbe duke i përkrahur nismat që i fuqizojnë anëtarët e komunitetit serb për të marrë pjesë aktivisht në proceset vendim-marrëse.
- T'i promovuar përpjekjet paqëndruese të organizatave bazë përmes organizimeve dhe nismave lokale.
- Ta inkurajuar bashkëpunimin ndëretnik në nivelin lokal për t'i adresuar sfidat dhe mundësitë e përbashkëta.
- Të avokuar për përfshirjen e këndvështrimeve serbe në politikë-bërjen rajonale dhe kombëtare.
- Të udhëhequr përmes shembullit duke demonstruar përkushtim ndaj tolerancës, mirëkuptimit, dhe respektimit për diversitetin në vetë veprimet dhe politikat tuaja.

Duke i ndërmarrë këta hapa, ju mund të ndihmoni ta krijojmë një shoqëri më harmonike dhe më përfshirëse për të gjithë qytetarët e Kosovës. Duke e theksuar rëndësinë e nismës dhe të udhëheqësisë lokale serbe, ne mund ta krijojmë një paqe më të drejtë dhe më të qëndrueshme në Kosovë.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Robert Muharremi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv**  
**Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

E dashura Prof. Dr. Ljiljana Šubarić,

Quhem Dušan Radaković dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë kam qenë thellësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe të bashkëpunimit ndër-etnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për ta promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Si Kryetare e Komunës së Graçanicës, si një komunë me shumicë serbe, udhëheqja juaj është kyçe në promovimin e ndjenjës së unitetit dhe të respektimit të ndërsjellë midis komuniteteve serbe dhe shqiptare. E pres përkrahjen tuaj në zbatimin e projekteve të komunitetit që këto komunitete i bëjnë bashkë për të punuar për qëllime të përbashkëta.

Dëshira ime është ta shoh një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike është shndërruar në një tipar përkufizues të Kosovës, dhe posaçërisht në komunat si Graçanica. E parashoh një të ardhme ku Graçanica shërben si model për bashkëjetesë paqësore, me hapësira të përbashkëta publike dhe ngjarje kulturore të përbashkëta që e lartësojnë diversitetin e pasur të rajonit.

Ju nxis të vazhdoni t'i udhëhiqni përpjekjet për ta ndërtuar një komunitet paqësor dhe përfshirës duke i angazhuar aktivisht banorët, si serbë, ashtu edhe shqiptarë, duke i përkrahur nismat që e nxisin dialogun, dhe duke siguruar që politikat lokale t'i pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e të gjitha grupeve etnike.

Këtë letër po e përfundoj me një vërejtje pozitive, duke shprehur besimin tim se së bashku Graçanicën mund ta bëjmë një pishtar të bashkëjetesës multietnike në Kosovë. I pres në të ardhmen përpjekjet tona të përbashkëta në krijimin e një shoqërie më harmonike për të gjithë.

Përsëritet më të sinqerta,

Dušan Radaković

**Ilir Deda,  
Aktivist i Shoqërisë Civile  
Prishtinë, Kosovë**

E dashura Kryetare Šubarić,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë. Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta filluar krijimin e kulturës së paqes dhe për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e bashkëjetesës dhe të mirëkuptimit multietnik. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash, kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Unë besoj se janë disa veprime afatshkurta dhe disa afatgjata që mund të shikohen dhe që potencialisht mund të vendosen si praktika. Këta hapa janë të përqendruar kryesisht në bashkëpunimin ndër-komunal, dhe para së gjithash midis komunës së Graçanicës dhe të Prishtinës.

Besoj se e ndani qëndrimin tim se niveli i ndërveprimit midis njerëzve, dhe posaçërisht niveli i mobilitetit të rinjve nga Graçanica në Prishtinë nuk janë aty ku të gjithë ne do të donim t'i shihnim. Me qëllim që ta promovojmë një ndërveprim më të lartë, ia vlen të shikohen sugjerimet në vijim:

1. Takimet e rregullta midis juve dhe Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me qëllim që të diskutohen projektet me përfitime reciproke, përfshirë këtu planifikimin dhe implementimin e përbashkët për lidhje më të madhe midis Graçanicës dhe Prishtinës dhe për projekte të përbashkëta ekonomike midis tyre;
2. Mundësisht të themelohet një Qendër Multi-Etnike e Rinisë në Prishtinë dhe në Graçanicë, si një hapësirë ku të rinjtë do të takoheshin dhe do të njiheshin me njëri-tjetrin. Kjo Qendër mund të shërbejë po ashtu edhe si hapësirë për art, kulturë, dhe për takime të specialistëve të IT-së – fusha këto ku të rinjtë janë me më së shumti gjasë të bashkëpunojnë.
3. Promovimi i përbashkët i mirëkuptimit multietnik dhe ndërjetar nga Graçanica dhe Prishtina, përfshirë këtu edhe një ngjarje simbolike vjetore që do të organizohej bashkarisht nga të dyja komunat.

Unë besoj se çdonjëri prej nesh e ka një rol për ta luajtur në promovimin e mirëqenies së popujve tonë bazuar në vlerat universale të respektimit të ndërsjellë, paqes, bashkëjetesës dhe mirëkuptimit më të madh. Ne kemi nevojë më shumë se kurrë më parë të fillojmë të punojmë drejt kulturës së paqes në Kosovë, e në të cilën Graçanica e ka një rol qendror. Shpresoj sinqerisht se do të shikoni edhe ide të mëtutjeshme që do t'i kontribuojnë mirëqenies dhe tolerancës midis qytetarëve dhe popujve të Kosovës.

Me përshëndetjet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë  
Instituti Evropian për Paqe  
Bruksel - Prishtinë**

E nderuara Kryetare e Komunës Šubarić,

Quhem Senad Šabović, dhe jam duke ju shkruar si përkrahës i projektit të quajtur *Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë*. Punoj si Këshilltar i Lartë me Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin parësor në përkrahjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile, të quajtur Alternativa Kosovare Civike (KCA – Kosovo Civic Alternative), e cila përpiqet ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë.

Është pjesë e këtij projekti që ne ta shkruajmë nga një letër të pritjeve për bashkëbiseduesit e respektuar me të cilët takohemi në komunat e përfshira. Prandaj kjo letër ka për qëllim t'i shpreh pritjet e mia nga Ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Në qasjen tonë, ne jemi të shtyrë nga parimet e multietnicitetit që janë të rrënjosura fuqishëm në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Këto po ashtu vazhdojnë të jenë pritja kyçe e bashkësisë ndërkombëtare sa i përket Kosovës. Për momentin, këto vlera nuk mbështeten detyrimisht nga të gjitha palët e përfshira në Kosovë, mirëpo ka mjaft shumë prej tyre – nga spektri politik, ai i mediave, dhe i shoqërisë civile – që vazhdojnë të besojnë në këto vlera dhe janë duke punuar për ta forcuar zbatimin e tyre. Ata që këto i çmojnë kanë nevojë për partnerë, ashtu që së bashku ta tregojnë se multi-etniciteti kryen punë dhe se është këtu për të mbetur.

Unë besoj se si Kryetare e një Komune me shumicë serbe ju nuk ndjeheni detyrimisht e fuqizuar për t'i nisur angazhimet e këtij lloji. Kjo është posaçërisht e kuptueshme në rrethanat e tashme të marrëdhënieve të tendosura ndëretnike dhe të procesit të ngujuar të normalizimit. Komuniteti serb, jo vetëm në Veri, është i brengosur me të drejtë dhe do të shikojë në udhëheqësit e vet për përgjigje. Me qëllim që përgjigjet të jenë efektive, ato duhet ta përfshijnë atë që të jenë të hapura edhe ndaj nismave të singërta multietnike që vijnë nga spektri shoqëror-politik i përgjithshëm i Kosovës. Ata që nuk e mbështesin multietnicitetin në Kosovë janë pikërisht ata që përfitojnë nga dështimi i nismave të tilla nga ata që dojnë ta mbështesin atë. Projekti jonë kohëve të fundit e ka bërë një varg takimesh në Prishtinë, përfshirë edhe me Kryetarin e Komunës, Përparim Rama, në të cilat na kanë siguruar fuqishëm se ekziston vullneti i mirë dhe se kohëve të fundit janë bërë përpjekje për ta rritur shtrirjen e kësaj.

Në dritën e kësaj të tërës, kolegët nga projekti dhe unë do të donim t'ju inkurajojmë që t'u përgjigjeni këtyre nismave – dhe që madje edhe vetë të ndërmerrni të tilla sa herë ta shihni se kjo është me vend – si dhe t'ju ofrojmë disa sugjerime. Thënë përgjithësisht, shfrytëzimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, ose përmbajtje të përbashkëta të mediave sociale, nga Ju dhe nga komuna në gjuhët e komuniteteve, për shembull, me rastin e ditëve të tyre kombëtare apo të festave fetare. Kjo mund të përfshijë po ashtu edhe vizita të publikuara të përbashkëta me kryetarët e komunave fqinje në qendrat e komuniteteve apo në lagjet multietnike, duke e inkurajuar kështu bashkëjetesën paqësore dhe multietnicitetin.

Më në veçanti, mund të ndërmerret një nismë drejt projekteve të përbashkëta ndërkomunale me Prishtinën dhe me komuna të tjera përreth – të cilat më vonë mund të shtrihen edhe në rajone të tjera. Kjo do të ishte një mënyrë shumë e mirë e angazhimit për ndërtimin e besimit të orientuar drejt zhvillimit. Kjo mund të zhvillohet në një strukturë të qëndrueshme bashkëpunuese ndërkomunale, e cila më pastaj mund të angazhohet me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe

mbase edhe në format e tjera të asociacioneve komunale në projektet që e pasqyrojnë të njëjtin koncept.

E nderuara Kryetare e Komunës, jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur KCA, do të jenë të gatshëm që me kënaqësi të ofrojnë mbështetje konkrete, për Ju dhe për ekipin Tuaj, në ekzekutimin e sugjerimeve që janë dhënë këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Šabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Prishtinë, Kosovë**

E dashura Kryetare e Komunës, Dr. Šubarić,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe për momentin punoj si Udhëheqës i Hulumtimit në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS – Kosovar Centre for Security Studies). Me formim në studimet e paqes dhe të konflikteve, dhe me titullin Master nga Universiteti St. Andrews dhe PhD-në nga Dublin City University, unë karrierën time ia kam kushtuar avancimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe me diversitet. Shtegtimi im profesional ka përfshirë role si aktivist, udhëheqës organizativ, dhe Zëvendës-Ministër për Integrimet Europiane.

Kushtetuta e Kosovës e parasheh një të ardhme ku vendi jonë është i lirë, demokratik, paqedashës, dhe shtëpi për të gjithë qytetarët e vet. Ky vizion është thelbësor për qëllimin tonë të përbashkët që një ditë të bëhemi pjesë e Unionit Europian, dhe është përgjegjësi jona kolektive për ta realizuar këtë vizion.

Si Kryetare e Komunës së Graçanicës, dhe e vetmja femër që shërben si kryetare e komunës në Kosovë, ju e keni një rol kyç në promovimin e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndër-etnik. Unë i lavdëroj hapat që tashmë i keni ndërmarrë, të tillë si caktimi i Zëvendës Kryetarit për Komunitete nga komuniteti shqiptar, dhe për forcimin e një atmosfere përgjithësisht pozitive ndëretnike në Graçanicë. Mirëpo, unë besoj se ka potencial për të bërë madje edhe më shumë, dhe këtu do të doja t'i sugjeroj tri nisma për konsiderimin tuaj.

Së pari, ju inkurajoj ta shikoni mundësinë e organizimit të ngjarjeve në shkollat e Graçanicës të cilat e krenojnë diversitetin e Kosovës. Këto ngjarje mund t'i edukojnë nxënësit e grupeve të ndryshme etnike në Kosovë, ku organizatat e shoqërisë civile do ta ndihmonin planifikimin dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve.

Së dyti, ju sugjeroj ta vendosni një theks më të madh në funksionalitetin e Komiteteve Komunale të Komuniteteve. Është e rëndësishme të sigurohet që këta mekanizma të takohen rregullisht, të paktën një herë në muaj, dhe që ata të shërbejnë si platforma efektive për dialogun ndëretnik. Pos kësaj, përfundimet dhe rekomandimet nga këto komitete duhet të adresohen në mënyrën e duhur nga komuna.

Së treti, ju ftoj juve, si Kryetare e Komunës së Graçanicës, që ta merrni një rol më proaktiv në mediat në Prishtinë. Duke folur për rëndësinë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndëretnik, dhe posaçërisht në mediat kombëtare të Kosovës, zëri juaj mund t'i kontribuojë në mënyrë domethënëse diskursit për të drejtat e pakicave dhe çështjet e interesit të përbashkët, të tilla si procesi i integritimit europian.

Jam i sigurtë se këto nisma, të kombinuara me udhëheqësinë tuaj të përkushtuar, do t'i rrisin në masë të madhe përpjekjet për ta ndërtuar një shoqëri më përfshirëse dhe më harmonike në Kosovë.

Ju falemnderit për vëmendjen tuaj për këto çështje

Sinqerisht,  
Ramadan Ilazi

**Dimitrije Obrenović,**  
**Koordinator i Projekteve,**  
**NGO Aktiv**  
**Mitrovica e Veriut, Kosovë**

E dashura Zonja Šubarić,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Quhem Dimitrije Obrenović, dhe jam aktivist serb i Kosovës i shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut. Jam thellësisht i përkushtuar ndaj përpjekjeve për pajtim midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke shkruar si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë për t'i ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multietnike në Kosovë.

Si Kryetare e Komunës, roli juaj për promovimin e politikave dhe ngjarjeve përfshirëse që i lartësojnë kulturat tona të ndryshme është thelbësor. Ju bëj thirrje të angazhoheni me komunitetet joshumicë, t'i adresoni brengat e tyre, si dhe ta siguronit përfaqësimin e tyre në qeverisjen lokale.

Duke shikuar përpara, vizioni im është ai i një Kosove ku bashkëjetesa multietnike është realitet. Shpresoj se në Prishtinë do të shoh qendra dhe nisma ndërkulturore që promovojnë dialogun, si dhe projekte të përbashkëta të komunitetit. Themelimi i një "Këshilli të Bashkëjetesës" me përfaqësues të grupeve të ndryshme etnike mund të jetë një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi.

Në përfundim, ju inkurajoj të vazhdoni ta ndërtoni një komunitet paqësor dhe përfshirës. Udhëheqësia juaj mund t'i frymëzojë të tjerët ta ndjekin shembullin, duke e krijuar një të ardhme ku çdonjëri në Kosovë ndjehet si në shtëpi të veten.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović



**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë  
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Prishtinë, Kosovë**

E nderuara Zonja Kryetare e Komunës Šubarić,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë.

Ndërkohë që po kalojmë nëpër kompleksitetet e bashkëjetesës multietnike në Graçanicë, jam i mbushur me shpresë për mundësitë që janë në kuadrin e përkushtimit tonë të përbashkët për ta rritur një shoqëri përfshirëse. Graçanica është një vend ku grupet e ndryshme etnike kanë bashkekzistuar me gjenerata, dhe ky diversitet është, si forcë, ashtu edhe sfidë. Ne jemi të përballur me tendosje në rrjedhje e sipër, të cilat, nëse nuk shqyrtohen, mund t'ia shkatërrojnë themelet strukturës shoqërore të komunitetit tonë. Megjithatë, besoj se përmes përpjekjeve, të qëllimshme, dhe bashkëpunuese, ne këto sfida mund t'i shndërrojmë në mundësi për rritje dhe mirëkuptim.

E respektoj përkushtimin tuaj për komunitetin në Komunën që jeni duke udhëhequr. Puna juaj dhe përkrahja e vazhdueshme e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë tashmë i kanë shtruar themelet për marrëdhënie më të mira midis grupeve të ndryshme etnike në komunë. Mirëpo, e ndjej se së bashku mund të arrihen shumë më tepër gjëra. Jam duke ju shkruar për ta ndarë vizionin tim për rritjen e bashkëjetesës multi-etnike në Graçanicë, me shpresë se mund të punojmë në bashkëpunim drejt një të ardhmeje më të ndritur.

Një nga shpresat e mia parësore është të shoh vendosjen e proceseve përfshirëse politikë-bërëse. Është vendimtare që të gjitha komunitetet të ndjehen të përfaqësuara dhe të dëgjua në marrjen e vendimeve që i ndikojnë jetët e tyre. Platformat për dialog do t'ju mundësojnë banorëve të kulturave të ndryshme që ata të kontribuojnë duke i dhënë këndvështrimet dhe idetë e tyre. Kjo nismë jo vetëm që do t'i fuqizojë individët por po ashtu do ta nxisë besimin dhe bashkëpunimin midis grupeve etnike.

Pos politikë-bërjes, besoj se dialogu dhe edukimi ndëretnik duhet të jenë në krye të përpjekjeve tona. Nismat që inkurajojnë mirëkuptim dhe respektim mund t'i thyejnë pengesat dhe t'i sfidojnë stereotipat. E parashoh një komunitet të punëve e diskutimeve të përbashkëta, të programeve të shkëmbimit kulturor, dhe të aktiviteteve edukative që e lartësojnë traditën tonë shekullore të multi-etnicitetit, pavarësisht nga kohët e vështira dhe tendosjet që ndodhin herë pas here. Nismat e tlla do ta ushqejnë ndjeshmërinë për njëri-tjetrin dhe do të krijojnë lidhje midis banorëve, duke çuar në fund në një shoqëri më kohezive.

Për më tepër, ngjarjet kulturore dhe shoqërore e luajnë një rol jetik në ndërtimin e lidhjeve brenda komunitetit. Organizimi i festivaleve që i shfaqin traditat e pasura të grupeve të ndryshme etnike mund të ndihmojë në lartësimin e diversitetit tonë ndërkohë që e promovon ndjenjën e përkatësisë. Ngjarjet që i bashkojnë familjet dhe individët e kulturave të ndryshme mund t'i forcojnë miqësitë dhe të krijojnë kujtime të paharrueshme të cilat i kapërcejnë ndarjet etnike.

Fuqizimi ekonomik është po ashtu thelbësor për forcimin e bashkëjetesës paqësore. E inkurajoj komunën që t'i promovojë mundësitë e barabarta ekonomike për të gjithë banorët. Përkrahja e bizneseve lokale, posaçërisht e atyre që e përqafojnë diversitetin etnik në fuqinë e vet punëtore, mund ta krijojë një ekonomi që lulëzon dhe nga e cila përfitojnë të gjithë. Nismat që synojnë krijimin e vendeve të punës dhe ndërmarrësinë jo vetëm që i përmirësojnë jetët e njerëzve, por edhe i fuqizojnë lidhjet e komunitetit.

Dhe, së fundi, angazhimi i rinisë sonë në nismat multi-etnike është kyç për ndërtimin e një të ardhmeje që është e rrënjësuar në mirëkuptim dhe bashkëpunim. Duke i përfshirë të rinjtë në projekte bashkëpunuese, ne ata mund t'i pajisim me shkathtësi dhe vlera të domosdoshme për udhëheqësi efektive. Energjia dhe kreativiteti i tyre mund të çojnë në ndryshime pozitive, duke frymëzuar gjeneratat e ardhshme për ta përqaftuar diversitetin.

Jam përplot dëshirë që Graçanicën ta shoh si model të bashkëpunimit ndër-etnik në Kosovë. Besoj mirëfilli se, nën udhëheqësinë tuaj dhe me përpjekjet kolektive të komunitetit, mund ta krijojmë një mjedis ku çdonjëri do të ndjehet i vlerësuar dhe i respektuar.

Ju falemnderit për marrjen në konsideratë të mendimeve dhe ideve të mia. E pres mundësinë për të punuar së bashku për ta rritur bashkëjetesën multi-etnike në komunën tuaj.

Përshëndetjet më të mira,

Mentor Agani

**Zoran Savič, Koordinator i Projekteve**  
**NGO AKTIV**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

E dashura Ljiljana Šubarić,

Quhem Zoran Savić, dhe jam Koordinator i Projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në fakt kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite me radhë dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh që po ashtu jam edhe muzikan, dhe kam marrë pjesë në projekte të ndryshme ndëretnike me muzikanë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për vite të shumta kam punuar si gazetar në portalin Kosovo Sever, KosSev, dhe përmes kësaj pune jam bërë edhe më i afërt me situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Pozita juaj si Kryetare e Komunës së Graçanicës mund të ndihmojë shumë në promovimin e mesazheve të paqes dhe të unitetit. Prandaj, jam duke pritur përkrahjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndëretnike dhe të projekteve të shërbimit në komunitet që përfshijnë punën e përbashkët të grupeve të ndryshme etnike.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multi-etnike në Kosovë do të jetë normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet etnike përqafohen si anë të forta, jo si burime të ndasive. Për këtë qëllim, ju mund të përqendroheshi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitetin dhe tolerancën kulturore, dhe të përkrahni projekte të përbashkëta të komunitetit.

Prandaj, ju inkurajoj që të merrni pjesë aktivisht në krijimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës duke përkrahur nismat ndëretnike, dhe duke i mbështetur politikatat që garantojnë mundësi të barabarta për çdonjërin.

Këtë letër po e përfundoj me një vërejtje shprese, duke e paraparë një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara e kultivojnë një shoqëri mirëfilli harmonike dhe shumëetnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Zoran Savič



## Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Šabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Hirësia e Tij, Peshkopi i Përndershëm Teodosije,  
Peshkop i Eparkisë së Rashkës e Prizrenit  
Kisha Ortodokse Serbe

Nëntor 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive  
Instituti i Prishtinës për Studime Politike  
Prishtinë, Kosovë**

I Nderuari Peshkop Teodosije,

Quhem Leonora Kryeziu, dhe jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një projekt ky i nisur nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Jam Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS – Prishtina Institute for Political Studies), një think-tank në Prishtinë, i themeluar 22 vite më parë nën përkujdesin e Këshillit të Europës. Misioni jonë është ta promovojmë një kulturë të re politike në Kosovë, të rrënjosur në vlerat thelbësore të Kushtetutës sonë – lirisë, demokracisë, dhe paqes, dhe ta bëjmë Kosovën atdhe të të gjithë qytetarëve të vet. Gjatë dy dekadave të kaluara karrierën time ia kam përkushtuar përparimit të këtyre parimeve demokratike dhe forcimit të kohezionit shoqëror anembanë Kosovës. Mirëpo, përpjekjet tona janë duke u sfiduar gjithnjë e më shumë nga ndarjet gjithnjë e më të thella etnike, gjë kjo që e nënvizon nevojën urgjente për angazhim më të madh qytetar dhe për një qasje më proaktive në trajtimin e këtyre çështjeve. Në dritën e këtyre sfidave, i jam bashkuar Karvanit dhe një koalicioni tjetër të shoqërisë civile, Alternativës Qytetare Kosovare (KCA – Kosovo Civic Alternative), ku që të dyjat synojnë të japin kontribute konkrete drejt promovimit të paqes dhe të bashkëpunimit ndëretnik.

Si anëtare e Karvanit, më është kërkuar që në këtë letër t'i trajtoj dëshirat dhe pritjet e mia lidhur me promovimin e paqes dhe të bashkëjetesës harmonike etnike në Kosovë.

Unë besoj në fuqinë transformuese të dialogut dhe të dashamirësisë në tejkalimin e ndarjeve dhe ndërtimin e një shoqërie më përfshirëse dhe paqësore. Prandaj, është dëshira ime më e sinqertë ta shoh rritjen e dialogut të hapur dhe konstruktiv midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare. Bisedat e tilla duhet të jenë të rrënjosura në dëshirën e mirëfilltë për t'i kuptuar këndvështrimet, përvojat dhe aspiratat e njëri-tjetrit. Hirësia Juaj, si një udhëheqës fetar ju e keni një ndikim të thellë në promovimin e paqes dhe të bashkëjetesës ndëretnike. Si një udhëheqës moral dhe etik, ju mund ta ofroni një udhëheqje e cila i thekson vlerat e tilla si paqja, falja, dhe respektimi i ndërsjellë, duke i trajtësuar në këtë mënyrë qëndrimet dhe sjelljet, si të besimtarëve, ashtu edhe të komunitetit më të gjerë.

Pos kësaj, ju mund t'i përkrahni përpjekjet për pajtim duke i pranuar ankesat e mëparshme dhe duke i promovuar proceset e shërimit, të tilla si nismat dhe memorialet për tregimin e së vërtetës. Ju mund të jepni përkrahje për drejtësi dhe barazi, duke i adresuar çështjet e diskriminimit dhe duke i trajtësuar trajtimin e drejtë të të gjitha grupeve. Së fundi, duke edukuar komunitetin dhe duke frymëzuar gjeneratën e re për rëndësinë e bashkekzistencës dhe respektimin e diversitetit, ju mund ta luani një rol jetik në trajtësimin e një shoqërie më harmonike dhe më përfshirëse.

Në këtë kontekst, shpresoj në udhëzimet dhe udhëheqjen tuaj të çmuar në përkrahjen e këtyre nismave. Autoriteti juaj moral dhe përkushtimi juaj ndaj paqes mund të shërbejnë si pishtar i frymëzimit që duhet ndjekur nga të tjerët.

Jam i sigurtë se me udhëheqjen tuaj të çmuar dhe me përpjekjet tona kolektive, ne mund të bëjmë hapa domethënës drejt një shoqërie më paqësore dhe më kohezive. Pres me padurim t'i diskutojmë këto ide më tutje dhe t'i shikojmë mënyrat në të cilat mund të punojmë së bashku për t'i arritur këto aspirata të përbashkëta.

Sinqerisht,

Leonora Kryeziu

**Jovana Radosavljevič, Drejtoreshë Ekzekutive**  
**New Social Initiative**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

Hirësia Juaj,

Shpresoj që kjo letër t'ju gjejë shëndosh e mirë. Quhem Jovana Radosavljevič, dhe jam aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, dhe një serbe ortodokse. Jam thëllësisht e përkushtuar ndaj përpjekjeve për pajtimin e serbëve dhe të shqiptarëve të Kosovës. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkjetesë, për t'i ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multietnike në Kosovë dhe posaçërisht brenda komunitetit tonë.

Kisha Ortodokse Serbe gjithmonë ka qenë shtyllë e fuqisë shpirtërore dhe mbrojtjes kulturore të komunitetit serb në Kosovë. Udhëheqja juaj në kuadër të Eparkisë së Prizrenit e Rashkës është jetike në udhëheqjen e popullit tonë gjatë këtyre kohëve sfiduese. **Unë besoj se duke promovuar tolerancë, respektim, dhe mirëkuptim midis grupeve të ndryshme etnike, Kisha mund ta luaj një rol vendimtar në krijimin e paqes dhe të pajtimit.** Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis komuniteteve do ta ndihmojë ndërtimin e besimit dhe të respektimit të ndërsjellë.

**Është thelbësore ta çmojmë diversitetin tonë kulturor dhe fetar ndërkohë që sigurojmë që çdo individ të ndjehet i sigurtë dhe që identitetet e tyre do të respektohen dhe mbrohen.** E inkurajoj Hirësinë Tuaj të vazhdojë t'i përkrahë programet e komunitetit që i bëjnë bashkë njerëzit me prapavija të ndryshme, duke i promovuar veprimtaritë e përbashkëta dhe shkëmbimet ndërkulturore. Predikimet tuaja si dhe mesazhet publike mund ta theksojnë edhe më tutje rëndësinë e unitetit, të tolerancës, dhe të respektimit për të gjithë, pavarësisht nga prapavija e tyre etnike a fetare.

Në përfundim, me respekt kërkoj nga Hirësia Juaj që t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për rritjen e një komuniteti paqësor, përfshirës, dhe tolerant. **Udhëheqja juaj jo vetëm që është një pishtar i shpresës për besimtarët ortodoksë serbë, por po ashtu edhe një frymëzim për të gjithë ata që punojnë drejt një të ardhmeje ku çdonjëri në Kosovë do të ndjehet si në shtëpi.**

Ju falemnderit për kohën, udhëzimin, dhe përkushtimin ndaj komunitetit tonë.

Me respekt të thëllë,

Jovana Radosavljevič

**Dr. Robert Muharremi**  
**Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies**  
**Rochester Institute of Technology in Kosovo**  
**Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Peshkop Teodosije,

Qhem Robert Muharremi, dhe jam Drejtor i Qendrës për Studime të Paqes dhe Konfliktit në RIT në Kosovë. Jam duke ju shkruar për ta shprehur përkrahjen time të fuqishme për Karvanin Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një projekt ky i nisur nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV.

Ky projekt synon ta forcojë mirëkuptimin, pajtimin dhe bashkekzistencën paqësore ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë. Besoj se është një hap kyç drejt ndërtimit të një shoqërie më përfshirëse dhe më harmonike. Si një udhëheqës i respektuar shpirtëror, përkrahja juaj për këtë nismë do të ishte e paçmuar.

Jam i sigurtë që bekimi dhe inkurajimi juaj do t'i kontribuonin në mënyrë domethënëse suksesit të Karvanit Multi-Etnik. Besoj që ju do të vazhdoni ta përkrahni një Kosovë multietnike, pajtimin, dhe integrimin e komunitetit serb.

Do të doja të sugjeroj që Kisha Ortodokse Serbe do të mund t'i ndërmerre veprimet e veçanta vijuese për ta lehtësuar pajtimin dhe integrimin:

- T'i organizojë dhe t'i përkrahë dialogjet ndërfaqetare dhe ngjarjet për ta promovuar mirëkuptimin dhe respektimin midis komuniteteve të ndryshme fetare.
- Të ofrojë resurse dhe trajnim edukativ për udhëheqësit fetarë dhe anëtarët e komunitetit në tema të tilla si zgjidhja e konflikteve, të drejtat e njeriut, dhe komunikimi ndërkulturor.
- T'i përkrahë nismat që e promovojnë kohezionin shoqëror dhe pjesëmarrjen qytetare në të gjitha grupet etnike në Kosovë.
- Të flasë kundër diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, dhe dhunës ndaj cilitdo komunitet.
- Ta inkurajojë pjesëmarrjen e të rinjve në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe për pajtim.

Duke i ndërmarrë këta hapa, Kisha Ortodokse Serbe mund ta luaj një rol jetik në rritjen e kulturës së paqes dhe të tolerimit në Kosovë. Kontributi juaj lidhur me këtë është thelbësor.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dr. Robert Muharremi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv  
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)  
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

Hirësia Juaj, Peshkop Teodosije,

Quhem Dušan Radaković dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë kam qenë thëllësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe të bashkëpunimit ndër-etnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për ta promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Pritjet për Bashkëjetesë: Si udhëheqës shpirtëror i Kishës Ortodokse Serbe në Eparkinë e Prizrenit e Rashkës, udhëheqja juaj është instrumentale në promovimin e paqes e të pajtimit në mesin e besimtarëve. Shpresoj se do t'i inkurajoni nismat që do t'i bëjnë bashkë njerëzit me prapavija të ndryshme etnike, duke e nxitur kështu frymën e mirëkuptimit dhe të respektimit të ndërsjellë.

Si e shihni Kishën Ortodokse Serbe duke e luajtur rolin në përparimin e harmonisë ndër-etnike në Kosovë?

Çfarë veprimesh apo programesh të veçanta mund t'i ndërmerret Kisha për t'i forcuar marrëdhëniet midis komuniteteve serbe dhe shqiptare?

Dëshirat për të Ardhmen: Dëshira ime është për një të ardhme ku Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë shihet si një urë midis komuniteteve, duke nxitur dialog dhe bashkëpunim. E parashoh një të ardhme ku kishat nuk janë vetëm vende të adhurimit, por po ashtu edhe qendra të shkëmbimit kulturor dhe të ndërtimit të komunitetit përmes vijave etnike.

Çfarë është vizioni juaj afatgjatë për rolin e Kishës në promovimin e bashkëjetesës multi-etnike në Kosovë?

Si mund t'i kontribuojnë mësimet e Kishës dhe aktivitetet e komunitetit të ardhmes paqësore dhe përfshirëse?

Thirrja për Veprim: Ju nxis me respekt të vazhdoni të udhëheqni përmes shembullit, duke inkurajuar klerin dhe grumbullimet tuaja që të angazhohen në dialogun ndër-etnik, t'i përkrahin nismat paqësore, dhe t'i mbështesin politikatat që promovojnë barazinë dhe drejtësinë për të gjitha grupet etnike.

Këtë letër e përfundoj me një shpresë për një të ardhme ku Kisha Ortodokse Serbe dhe udhëheqësit e saj janë na krye të ndërtimit të një shoqërie harmonike dhe multi-etnike në Kosovë. Jam i bindur që, nën udhëheqjen tuaj, ne mund ta bëjmë një përparim domethënës drejt një qëllimi të tillë fisnik.

Përsëritjet më të sinqerta,

Dušan Radaković



## **Ilir Deda, Aktivist i Shoqërisë Civile Prishtinë, Kosovë**

Hirësia Juaj, Peshkop i Përndëruar Teodosije,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe avancimin e diversitetit, të multi-etnicitetit dhe të multi-konfesionalizmit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre në këto kohë të vështira është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen Tuaj, dhe të Eparkisë së Rashkës-Prizrenit në gjetjen e shtigjeve për ta promovuar bashkëjetesën multietnike dhe multifetare në Kosovë. Unë besoj fuqishëm se kjo është posaçërisht e rëndësishme tash, kur qëndrimet populiste dhe ekskluziviste janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare duhet të ruhet dhe të çohet përpara edhe më tutje. Kisha Ortodokse Serbe si një institucion shumë i vjetër në Kosovë, e ka një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe përhapjen e kësaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurtra dhe disa afatgjata që Ju mund t'i ndërmerrni dhe që ato t'i shndërrojnë në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e mëparshme.

Në të kaluarën ka qenë një praktikë ku udhëheqësit fetarë njëri-tjetrit ia uronin publikisht festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte një hap fillestar drejt avancimit të respektit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do ta nënkuptonte respektimin e festave më të rëndësishme fetare për anëtarët e komuniteteve Islamike, Katolike dhe Protestante.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh është një formë moderne që synon avancimin e bashkëjetesës dhe të harmonisë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk është duke u vlerësuar, unë besoj se është koha e duhur për ta marrë parasysh vendosjen e dialogut ndërjetar në nivelin komunal, dhe për ta filluar krijimin e kulturës së paqes. Ky forum do ta çonte përpara mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, përfshirë mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ky po ashtu do të shërbente si një forum për t'i diksutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Mirëqenia dhe përparimi i Kishës Ortodokse Serbe dhe i popullit serb në Kosovë janë të lidhur ngushtë me mirëqenien dhe përparimin e të gjithë popujve dhe të institucioneve fetare në Kosovë. Në kohët kur udhëheqësit politikë çojnë përpara qëndrime përjashtuese, u mbetet individëve të vullnetit të mirë që të punojnë drejt vlerave universale të paqes, bashkëjetesës, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe multietnicitetit.

Me respekt të sinqertë,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë  
Instituti Evropian për Paqe  
Bruksel – Prishtinë**

E nderuara Hirësia Juaj, Peshkop Tedosije,

Quhem Senad Shabović dhe jam duke Ju shkruar si mbështetësi i projektit të quajtur *Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë*, i udhëhequr nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Punoj si Këshilltar i Lartë me Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin parësor në përkrahjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile, të quajtur Alternativa Kosovare Civike (KCA – Kosovo Civic Alternative), e cila përpiqet ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë.

Mund të më mbani mend nga koha e Misionit të OSCE-së në Kosovë, kur e udhëhiqja zyren politike dhe merrja pjesë në takime të shumta me Ju, që nga ato bilaterale, e deri te ato të ndërlidhura me Këshillin për Implementim dhe Monitorim dhe për Dialogun Ndërfetar. Gjatë të gjitha atyre viteve e deri te kjo ditë, unë kam qenë në tërësi nën përshtypjen e udhëheqësisë Suaj, të mënyrës si jeni mbajtur dhe si keni komunikuar me mjedisin e jashtëm të Kishës suaj, që nga bashkësia ndërkombëtare, e deri te institucionet e Kosovës, dhe kleri e pasuesit e feve të tjera. Mandati Juaj si Peshkop i Dioqezës së Rashkës e Prizrenit ka qenë një mundësi unike për përmirësimin e marrëdhënieve gjithandej, dhe shpresoj se potenciali i tij i plotë do të realizohet në periudhën që po vjen edhe përkundrajt sfidave evidente.

Në pajtim me qasjen e projektit, kjo letër e ka për qëllim që t'i shprehë pritjet e mia nga Ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Në qasjen tonë, ne udhëhiqemi nga parimet e shoqërisë multietnike që janë të rrënjësura fuqishëm në sistemin ligjor dhe kushtetues të Kosovës. Këto po ashtu vazhdojnë të jenë pritja kryesore e bashkësisë ndërkombëtare dhe janë mekanizmi parësor për mirëqenien e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, dhe në veçanti të komunitetit serb. Ne kemi shpresa të mëdha që këto parime do t'i shohim të pasqyruara në jetën fetare në Kosovë. Lidhur me këtë duhet të kryhet një punë e madhe, dhe kjo duhet të forcohet dhe zgjerohet edhe më tutje, dhe posaçërisht në këtë kohë të tendosjeve të rritura dhe të ngecjes së normalizimit. Gjatë viteve, pjesëmarrja aktive e Kishës suaj në aktivitetet e ndryshme të dialogut ndërfetar dhe në format e tjera të ndryshme të kontributimit për bashkëjetesën paqësore me siguri se e kanë lënë shenjë e vet.

Kolegët nga projekti dhe unë do të donim t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma dhe po ashtu do të donim t'ju ofrojmë disa sugjerime lidhur me këtë. E kuptoj fare mirë pozitën unike të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) në Kosovë dhe ndjeshmëritë që vijnë me një pozitë të tillë. Megjithatë, kontributi juaj aktiv në rritjen e ndjenjës së multi-etnicitetit dhe të tolerimit – ashtu siç në të vërtetë edhe ka qenë – do ta krijojnë një vlerë të rëndësishme të shtuar. Kështu, qoftë nga aspekti i përgjigjes ndaj nismave pozitive të jashtme, ose i vetë nismave tuaja, duhet të shfrytëzohet çdonjëra mundësi që multietniciteti të paraqitet dhe të theksohet si vlerë. Mund të ketë të tillë në mesin e palëve pjesëmarrëse të Kosovës që e trajtojnë një atmosferë tjetërfare, një që devijon nga parimet e multietnicitetit, por ende ka shumë të tillë në jetën fetare, politike, atë të mediave dhe të shoqërisë civile në Kosovë, e që mbeten vërtetë të përkushtuar ndaj këtyre parimeve. Për këtë jemi siguruar në takimet tona në Prishtinë me Kryetarin e Komunës, me Peshkopin Katolik, dhe me Kryeimamin e Bashkësisë Islamike. Për shembull, ne kemi mësuar se është një program vizitues midis Kishës Tuaj dhe Bashkësisë Islame (Bogoslovia dhe Medreseja), diçka kjo që është shumë e këndshme për ta dëgjuar. Shtimi i programeve sikur ky do të ishte shumë i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, përmbajtje të përbashkëta të mediave sociale, apo vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë dhe institucionalë në qendrat

e komuniteteve apo në vendet e tyre të rëndësishme. Theksimi i mesazheve të tolerancës dhe të respektimit të Besimit Tuaj, si mesazhet e duhura, në angazhimet Tuaja me besimtarët do të jetë po ashtu një mënyrë efektive e kontribimit.

Më konkretisht, përfaqësuesve të tjerë fetarë që ndodhen në Prishtinë u kam sugjeruar po ashtu edhe krijimin e një këshilli të udhëheqësve të Besimeve të ndryshme në Kosovë që do t'i koordinonte dhe këshillonte institucionet kosovare dhe donatorët ndërkombëtarë lidhur me mbrojtjen dhe rehabilitimin e vendeve të cenushme fetare anembanë Kosovës. Ju dhe Kisha Juaj mund të dëshironi ta shqyrtoni nisjen e një kësi përpjekjeje. Kjo jo vetëm që do ta përmirësonte gjendjen fizike të këtyre vendeve e objekteve, por po ashtu edhe do ta rikonfirmonte mesazhin e tolerancës dhe të respektimit, që është përbërësi i Besimit.

Hirësia Juaj, mund të jini të sigurtë që kolegët e mi nga Instituti European i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i sipërpërmendur KCAs, do të jetë të gatshëm që me kënaqësi t'ju ofrojnë përkrahje konkrete, Juve, dhe bashkë-udhëheqësve Tuaj fetarë, për zbatimin e sugjerimeve të dhëna këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Šabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Peshkop Teodosije,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe për momentin punoj si Udhëheqës i Hulumtimit në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS – Kosovar Centre for Security Studies). Me formim në studimet e paqes dhe të konflikteve, dhe me titullin Master nga Universiteti St. Andrews dhe PhD-në nga Dublin City University, unë karrrierën time ia kam kushtuar avancimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe me diversitet. Shtegtimi im profesional ka përfshirë role si aktivist, udhëheqës organizativ, dhe Zëvendës-Ministër për Integrimet Europiane.

Kushtetuta e Kosovës e parasheh një të ardhme ku vendi jonë është i lirë, demokratik, paqedashës, dhe shtëpi për të gjithë qytetarët e vet. Ky vizion është thelbësor për qëllimin tonë të përbashkët që një ditë të bëhemi pjesë e Unionit Europian, dhe është përgjegjësi jona kolektive për ta realizuar këtë vizion.

Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë e luan një rol domethënës në promovimin e paqes, tolerancës dhe të bashkëpunimit ndër-etnik. Udhëheqësia juaj mund t'i frymëzojë përpjekjet që e theksojnë respektimin e ndërsjellë, dhe në këtë kontekst, do të doja t'i propozoj dy ide, që nuk janë të reja, për ta rritur më tutje mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë.

Së pari, ju ftoj që publikisht t'i përkrahni dhe mbështesni përpjekjet dhe veprimtaritë e organizuara nga organizatat e shoqërisë civile, si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia, të cilat njerëzit i bëjnë bashkë dhe e ofrojnë një platformë për dialog dhe bashkëpunim, dhe posaçërisht ndër të rinjtë. Në klimën e tashme politike midis Kosovës e Serbisë, është kyçe që të kemi zëra nga Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë që i përkrahin udhëheqësit e shoqërisë civile si dhe aktivitetet që i promovojnë pajtimin dhe normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Unë jam posaçërisht i brengosur për trendin në rrjedhje e sipër të radikalizimit etno-politik, dhe posaçërisht në mesin e të rinjve në Kosovë dhe në Serbi, e të cilët nuk janë shumë përkrahës të përpjekjeve për pajtim.

Së dyti, ju inkurajoj ta merrni një rol proaktiv në promovimin e dialogut ndër fetar. Është e rëndësishme për qytetarët e Kosovës të shohin më shumë raste ku ju dhe udhëheqësit e tjerë fetarë takohen dhe dërgojnë mesazhe të përbashkëta të gjithë qytetarëve në Kosovë. Do të doja po ashtu t'ju inkurajoj ta shikoni bashkëpunimin e mëtutjeshëm me udhëheqësit e tjerë fetarë, të tillë si ata nga Bashkësia Islame e Kosovës, Komuniteti Katolik, Kisha Protestante, dhe të tjerë. Ne e kemi një nevojë urgjente që të gjithëve t'ju shohim sa më shpesh bashkë dhe duke dhënë mesazhe të tolerancës dhe të mirëkuptimit.

Ju falemnderit për vëmendjen tuaj për këto çështje.

Sinqerisht,  
Ramadan Ilazi

**Dimitrije Obrenović,**  
**Koordinator i Projekteve,**  
**NGO Aktiv**  
**Mitrovica e Veriut, Kosovë**

I dashuri Peshkop Teodosije,

Quhem Dimitrije Obrenović, dhe jam një aktivist i të drejtave të njeriut që jetoj në Mitrovicën e Veriut. Jam thellësisht i përkushtuar për të drejta të barabarta njerëzore dhe për nxitjen e bashkëpunimit ndërfaqetarak, duke besuar fuqishëm që për një ardhmëri më të mirë është i nevojshëm një bashkëpunim i mëtutjeshëm.

Udhëheqja juaj në Kishën Ortodokse në Kosovë juve ju vë në një pozitë unike për ta promovuar harmoninë ndër-etnike. Inkurajimi i dialogut dhe i bashkëpunimit midis grupeve të nryshme fetare dhe etnike mund ta rrisë unitetin në komunitetet tona në një mënyrë domethënëse. Ju nxis t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz nga të gjitha fushat e jetës. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike duhet të vazhdojnë ta theksojnë rëndësinë e unitetit, tolerancës dhe të respektit për të gjithë.

Duke shikuar përpara, unë e parashoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike është një realitet. Takimet e rregullta ndërfaqetarak dhe nismat ndër-kulturorë mund ta nxisin dialogun dhe bashkëpunimin.

Në përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqësia juaj mund t'i frymëzojë të tjerët ta krijojnë një të ardhme ku në Kosovë çdonjëri do të ndjehet si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë  
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Prishtinë, Kosovë**

Hirësia e Nderuar, Peshkopi Teodosije,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë.

Jam duke ju shkruar me një respekt të thellë për drejtimin tuaj të palëkundur dhe udhëheqjen shpirtërore që ua ofroni besimtarëve ortodoksë në Kosovë. Në këto kohë, si të sfidës, ashtu edhe të mundësive, jam duke ju drejtuar me dëshirën për ta diskutuar të ardhmen e bashkëjetesës multi-etnike në rajonin tonë – një e ardhme kjo që besoj se mund të trajtësohet në një masë të madhe nga ndikimi dhe mençuria juaj.

Si një person i përkushtuar për forcimin e paqes dhe të mirëkuptimit, jam shumë mirë i vetëdijshëm për rolin vendimtar që Kisha luan në shoqërinë tonë. Eparkia e Rashkës dhe e Prizrenit, me rrënjët e veta të thella historike dhe rëndësinë spirituale, e ka një pozitë unike në promovimin e pajtimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme

Historia e Kosovës është komplekse, dhe plagët e së kaluarës ende kumbojnë brenda shumë zemrave, përfshirë edhe timen. Mirëpo, unë besoj fuqishëm se përmes ndjeshmërisë për njëri-tjetrin, dialogut, dhe përkushtimit të përbashkët ndaj humanitetit tonë të përbashkët, ne mund t'i tejkalojmë këto ndarje dhe ta ndërtojmë një shoqëri ku çdo individ, pavarësisht nga prapavija e vet etnike a fetare, mund të jetojë në paqe dhe me dinjitet.

Është shpresë imja që ne mund të punojmë së bashku për ta arritur këtë vizion. Jam i bindur që udhëheqja juaj mund të frymëzojë ndryshime pozitive dhe se Kisha mund të shërbejë si një urë midis komuniteteve. Unë i shoh disa fusha ku mund t'i përqendrojmë përpjekjet tona:

**Inkurajimi i Dialogut Ndërfetar dhe Ndëretnik:** Dialogu është hapi i parë drejt mirëkuptimit dhe pajtimit. Duke i ndihmuar bisedimet midis udhëheqësve dhe anëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, ne mund ta fillojmë rrënimin e pengesave që na ndajnë. Zëri juaj, si një udhëheqës i respektuar shpirtëror, mund t'ua japë një peshë të konsiderueshme këtyre përpjekjeve.

**Promovimi i Vlerave të Përbashkëta të Ndjeshmërisë për Njëri-Tjetrin dhe Paqen:** Mësimet e Kishës e theksojnë dashurinë, faljen, dhe paqen – vlera këto që janë universale dhe mund t'i bashkojnë njerëzit në të gjitha fushat e jetës. Duke i nënvizuar këto vlera të përbashkëta, ne mund ta ushqejmë ndjenjën e qëllimit të përbashkët dhe të respektit të ndërsjellë ndërmjet popullatave të ndryshme të Kosovës.

**Përkrahja e Angazhimit të Rinisë dhe e Ndërtimit të Paqes:** Rinia është e ardhmja e shoqërisë sonë, dhe është vendimtare që ata të jenë të përfshirë në këto përpjekje. Duke i inkurajuar të rinjtë për të marrë pjesë në nismat që e promovojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, ne atyre mund t'u ndihmojmë për të ndërtuar një të ardhme ku gabimet e të kaluarës nuk do të përsëriten. Programet e Kishës të rinisë mund ta luajnë një rol jetik lidhur me këtë.

**Bashkëpunimi në Projektet e Komunitetit:** Veprimet praktike flasin me zë më të lartë se fjalët. Duke punuar së bashku në projektet e komunitetit nga të cilat përfitojnë të gjithë banorët, pavarësisht prapavijës së tyre, ne mund ta demonstrojmë fuqinë e bashkimit dhe të

bashkëpunimit. Qoftë përmes nismave bëmirëse, programeve edukative, apo ngjarjeve kulturore, ka mënyra të shumta në të cilat mund ta bëjmë një ndryshim të prekshëm.

Hirësia Juaj, dua t'ju siguroj se ne jemi plotësisht të përkushtuar për përkrahjen e këtyre përpjekjeve. Ne jemi gati për të bashkëpunuar me ju dhe me Kishën për të ndihmuar krijimin e një Kosove më përfshirëse dhe paqësore. Ju lutem që ta keni parasysh se në këto përpjekje e keni përkrahjen tonë të palëkundur.

Ju falemnderit për kohën tuaj dhe për marrjen parasysh të mendimeve të mia. E pres me padurim mundësinë e bashkëpunimit me ju për arritjen e këtyre qëllimeve të rëndësishme.

Përshëndetjet më të sinqerta,

Mentor Agani

**Zoran Savič, Koordinator i Projekteve  
NGO AKTIV  
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Peshkop Teodosije,

Quhem Zoran Savič, dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në fakt kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite me radhë dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh se jam po ashtu edhe muzikan, dhe kam marrë pjesë në projekte të ndryshme ndëretnike me muzikanë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për vite të shumta kam punuar si gazetar në portalin Kosovo Sever, KosSev, dhe përmes kësaj pune jam bërë edhe më i afërt me situatën politike, të sigurisë, dhe atë fetare në Kosovë.

Kisha Ortodokse Serbe ka qenë gjithmonë një gurthemel i komunitetit serb në Kosovë, duke i ofruar atij udhëheqje dhe mbështetje shpirtërore. Udhëheqja juaj në eparki juve ju vë në një rol kyç për rritjen e harmonisë ndëretnike. Nxitja e dialogut dhe e bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta forcojë në mënyrë domethënëse unitetin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis komuniteteve tona. Ju nxis që t'i përkrahni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që i bëjnë bashkë njerëzit e prapavijave të ndryshme. Predikimet dhe adresimet tuaja publike duhet të vazhdojnë ta theksojnë rëndësinë e unitetit, të tolerancës, dhe të respektimit të të gjithëve.

Duke shikuar përpara, e parashoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike dhe toleranca fetare janë të përqafuara. Takimet e rregullta ndërfitare, dhe nismat ndërkulturore, mund t'i forcojnë dialogun dhe bashkëpunimin.

Unë parashoh komunitete ku dallimet fetare janë të përqafuara si anë të forta, jo si burime të ndasive. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohni në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitetin dhe tolerancën fetare, të përkrahni projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe të siguroni një përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Këtë letër po e përfundoj me një vërejtje shprese, duke e paraparë një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara e kultivojnë një shoqëri mirëfilli harmonike dhe shumë-etnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj,

Zoran Savič





## Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Šabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

z. Xheladin Fazliu  
Imam

Shtator 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive  
Instituti i Prishtinës për Studime Politike  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Imam Xheladin Fazliu,

Quhem Leonora Kryeziu, dhe jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, projekt i nisur nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Jam Themeluese dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS – Prishtina Institute for Political Studies), një think-tank në Prishtinë, i themeluar 22 vite më parë nën përkujdesin e Këshillit të Europës. Misioni jonë është ta promovojmë një kulturë të re politike në Kosovë, të rrënjosur në vlerat thelbësore të Kushtetutës sonë – lirisë, demokracisë, dhe paqes, dhe ta bëjmë Kosovën atdhe të të gjithë qytetarëve të vet. Gjatë dy dekadave të kaluara karrierën time ia kam përkushtuar përparimit të këtyre parimeve demokratike dhe forcimit të kohezionit shoqëror në të tërë Kosovën. Mirëpo, përpjekjet tona janë duke u sfiduar gjithnjë e më shumë nga ndarjet gjithnjë e më të thella etnike, gjë kjo që nënvizon nevojën urgjente për angazhim më të madh qytetar dhe për një qasje më proaktive në trajtimin e këtyre çështjeve. Në dritën e këtyre sfidave, i jam bashkuar Karvanit dhe një koalicioni tjetër të shoqërisë civile, Alternativës Qytetare Kosovare (KCA – Kosovo Civic Alternative), ku që të dyjat synojnë të japin kontribute konkrete për promovimin e paqes dhe të bashkëpunimit ndëretnik.

Si anëtare e Karvanit, më është kërkuar që në këtë letër t'i trajtoj dëshirat dhe pritjet e mia lidhur me promovimin e paqes dhe të bashkëjetesës harmonike etnike në Kosovë.

Unë besoj në fuqinë transformuese të dialogut dhe të dashamirësisë në tejkalimin e ndarjeve dhe ndërtimin e një shoqërie më përfshirëse dhe paqësore. Prandaj, është dëshira ime më e sinqertë ta shoh rritjen e dialogut të hapur dhe konstruktiv midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare. Bisedat e tilla duhet të jenë të rrënjosura në dëshirën e mirëfilltë për t'i kuptuar këndvështrimet, përvojat dhe aspiratat e njëri-tjetrit.

E çmuj thellësisht rolin që udhëheqësit fetarë e luajnë në promovimin e unitetit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe fetare. Si një udhëheqës moral dhe etik, ju mund ta ofroni një udhëheqje që i thekson vlerat e tilla si paqja, falja, dhe respektimi i ndërsjellë, duke i trajtësuar në këtë mënyrë qëndrimet dhe sjelljet, si të besimtarëve, ashtu edhe të komunitetit më të gjerë.

Prandaj, ju ftoj t'i përkrahni përpjekjet tona, dhe që, në rolin tuaj, t'i bartni mesazhet e tolerancës dhe të paqes, duke i inkurajuar pasuesit tuaj për t'i përvetësuar këto vlera si thelbësore për bashkekzistencën tonë.

Së fundi, duke edukuar komunitetin dhe duke frymëzuar gjeneratën e re për rëndësinë e bashkekzistencës dhe të respektimit për diversitet, ju mund ta luani një rol jetik në trajtësimin e një shoqërie më harmonike dhe përfshirëse.

Në këtë kontekst, shpresoj për udhëzimin dhe udhëheqjen tuaj të çmuar në përkrahjen e këtyre nismave. Autoriteti moral dhe përkushtimi juaj ndaj paqes mund të shërbejë si pishtar i frymëzimit që të tjerët do ta ndjekin.

Jam i sigurtë se me udhëheqjen tuaj të çmuar dhe me përpjekjet tona kolektive, ne mund të ndërmarrim hapa domethënës drejt një shoqërie më paqësore dhe më kohezive.

Sinqerisht,

Leonora Kryeziu

**Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive**  
**New Social Initiative**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam Fazliu,

Shpresoj se kjo letër t'ju gjejë shëndosh e mirë. Quhem Jovana Radosavljević, dhe jam aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, e përkushtuar për pajtimin midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karavanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkjetesë për t'i ndarë pritjet dhe shpresat e mia për nxitjen e bashkëjetesës multi-etnike në Kosovë.

Roli juaj si Imam është jetik në udhëheqjen e komunitetit drejt mirëkuptimit, tolerancës dhe respektimit të ndërsjellë. Besoj se udhëheqja juaj mund t'i kontribuojë në masë të madhe tejkalimit të ndasive dhe forcimit të marrëdhënieve paqësore midis grupeve të ndryshme etnike në Kosovë. Duke promovuar dialogun, respektin dhe bashkëpunimin, ne mund ta krijojmë një mjedis ku çdokush do të ndjehet i sigurtë dhe i vlerësuar.

Është e rëndësishme ta çmojmë diversitetin tonë kulturor dhe fetar ndërkohë që sigurojmë se identiteti i çdo individi do të respektohet dhe mbrohet. Ju inkurajoj t'i mbështesni nismat që i bëjnë bashkë njerëzit e prapavijave të ndryshme, duke i nxitur projektet e përbashkëta të komunitetit, shkëmbimet ndërkulturore, dhe dialogjet që i theksojnë vlerat tona të përbashkëta. Predikimet dhe mesazhet publike tuajat mund ta nënvizojnë më tutje rëndësinë e unitetit, të tolerimit dhe respektimit të të gjithëve, pavarësisht nga dallimet etnike apo fetare.

Duke shikuar përpara, vizioni im është për një Kosovë ku bashkëjetesa multi-etnike është realitet i përçafuar nga të gjithë. Shpresoj të shoh përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis komuniteteve, me programe që e lartësojnë diversitetin dhe humanitetin tonë të përbashkët. Takimet e rregullta ndërfaqetare dhe nismat kulturore mund të ndihmojnë në forcimin e ndjenjës së unitetit dhe të qëllimit të përbashkët.

Në përfundim, ju nxis me respekt që t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqësia juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për të punuar drejt një të ardhmeje ku të gjithë popujt në Kosovë, pavarësisht nga prapavija e tyre, do të ndjehen të sigurtë, të respektuar, dhe në shtëpi të veten.

Me respekt të sinqertë,

Jovana Radosavljević

**Dr. Robert Muharremi**  
**Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies**  
**Rochester Institute of Technology in Kosovo**  
**Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Imam Xheladin Fazliu,

Quhem Robert Muharremi, dhe jam Drejtor i Qendrës për Studime të Paqes dhe Konfliktit në RIT në Kosovë. Jam duke ju shkruar për ta shprehur përkrahjen time të fuqishme për Karvanin Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, një projekt ky i nisur nga OJQ-të KIPRED dhe AKTIV. Unë po ashtu shpreh përkrahjen time të fuqishme për përpjekjet tuaja për ta promovuar pajtimin dhe integrimin midis komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike në Kosovë.

Si një udhëheqës i respektuar fetar brenda komunitetit mysliman, roli juaj në forcimin e shoqërisë paqësore dhe përfshirëse është i paçmueshëm. Besoj se duke e promovuar dialogun ndër-fetar dhe tolerancën, ju mund t'i kontribuoni në një masë domethënëse stabilitetit dhe progresit të përgjithshëm të Kosovës, dhe se kontributi juaj mund ta sjellë një ndryshim të rëndësishëm.

Do të doja t'ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për promovimin e dialogut ndër-fetar dhe të mirëkuptimit, për të folur kundër diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, dhe kundër dhunës ndaj cilitdo komunitet, pavarësisht nga besimet e tyre fetare, pastaj për t'i përkrahur nismat që e promovojnë kohezionin shoqëror dhe pjesëmarrjen qytetare në mesin e të gjitha grupeve etnike dhe fetare në Kosovë, dhe për ta inkurajuar përfshirjen e të rinjve në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe për pajtim.

Aktivitetet e veçanta që duhen ndërmarrë për ta përkrahur dialogun dhe tolerancën ndër-fetare përfshijnë:

- Organizimin e ceremonive të përbashkëta fetare për ta promovuar unitetin dhe mirëkuptimin.
- Krijimin e materialeve edukuese që i nënvizojnë vlerat e përbashkëta dhe historinë e përbashkët të komuniteteve të ndryshme fetare.
- Themelimin dhe përkrahjen e forumeve për dialogun ndër-fetar për ta ofruar një platformë për një diskutim të hapur dhe me respekt.
- Përkrahjen e nismave të bazuara në komunitet që e promovojnë punën e përbashkët dhe bashkëpunimin ndër-fetar.

Duke i ndërmarrë këta hapa, dhe përmes udhëheqjes përmes shembullit, ju mund ta ndihmoni krijimin e një shoqërie më harmonike dhe më përfshirëse për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Robert Muharremi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv  
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)  
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam Xheladin Fazliu,

Quhem Dušan Radaković, dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). Kam qenë thëllësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për ta promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë karrrierën time ia kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Pritjet për Bashkëjetesë: Si një udhëheqës i respektuar dhe pjesë integrale e Bashkësisë Islame të Kosovës, ndikimi juaj është kyç në promovimin e unitetit dhe të harmonisë shoqërore. Puna juaj përmes "Bereqetit," dhe posaçërisht për përkrahjen e familjeve të cënueshme, e pasqyron një përkushtim të thellë ndaj solidaritetit shoqëror. Shpresoj që udhëheqësinë tuaj të vazhdueshme do ta shoh në nismat që i bëjnë bashkë anëtarët e besimeve dhe etnive të ndryshme, duke e nxitur kështu respektimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

Dëshira ime është për një të ardhme ku Bashkësia Islame, nën udhëheqjen tuaj, e luan një rol kryesor në promovimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë. Unë xhamitë dhe organizatat Islamike në të ardhmen i shoh jo vetëm si vende të adhurimit, por po ashtu edhe si qendra për angazhimin e komunitetit që i tejkalon kufijtë etnikë.

Ju nxis me respekt që t'i vazhdoni përpjekjet udhëheqëse për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës duke e inkurajuar dialogun ndëretnik, duke i përkrahur nismat që e promovojnë mirëkuptimin, dhe duke i mbrojtur të drejtat e barabarta për të gjitha grupet etnike.

Këtë letër e përfundoj me optimizëm, i bindur që udhëheqësia juaj do t'i kontribuojë në një masë domethënëse realizimit të një shoqërie multietnike harmonike në Kosovë. I pres përpjekjet tona të përbashkëta për avancimin e kësaj kauze fisnike.

Përsëndetje të sinqerta,

Dušan Radaković

**Ilir Deda, Aktivist i Shoqërisë Civile  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Imam Fazliu,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e bashkëjetesës multietnike dhe multifetare në Graçanicë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash, kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare ka qenë njëra ndër vlerat thelbësore të kombit tonë, dhe Bashkësia Islame e Kosovës e ka një rol qendror në ruajtjen dhe promovimin e kësaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurta dhe disa afatgjata që ju mund t'i ndërmerrni dhe t'i shndërroni në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e mëparshme.

Në të kaluarën, ekzistonte një praktikë ku udhëheqësit fetarë njëri-tjetrit ia uronin publikisht festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte një hap fillestar drejt avancimit të respektimit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do ta nënkuptonte respektimin e festave më të rëndësishme fetare për anëtarët e komuniteteve katolike, protestante dhe ortodokse.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh janë forma moderne që synojnë avancimin e bashkëjetesës dhe të harmonisë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk është duke u vlerësuar, unë besoj se Kosova, duke pasur parasysh historinë e saj unike, mund ta vendosë një dialog ndërjetar në nivelin lokal komunal, për ta filluar krijimin e kulturës së paqes. Ky forum do ta çonte përpara mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, duke përfshirë këtu edhe mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ai do të shërbente po ashtu edhe si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Kosova do të jetë e suksesshme vetëm nëse e ruan karakterin e vet multi-etnik, dhe Bashkësia Islame e Kosovës e ka një rol kyç në ruajtjen dhe përparimin e këtij karakteri të shtetit tonë.

Unë besoj fuqishëm se udhëheqja juaj është kritike në këtë pikë të zhvillimit të vendit tonë dhe shpreh shpresën se do të merrni parasysh veprimet e propozuara.

Përshëndetjet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë  
Instituti Evropian për Paqe  
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Imam Fazliu,

Unë jam Senad Shabović, dhe jam duke ju shkruar si përkrahës i projektit të quajtur Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Punoj si Këshilltar i Lartë me Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin parësor në përkrahjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe në procesin e normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile, të quajtur Alternativa Kosovare Civike (KCA – Kosovo Civic Alternative), e cila përpiqet ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë.

Kjo letër ka për qëllim t'i shprehë pritjet e mia nga Ju për sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Siç e dimë, Republika e Kosovës është e përkufizuar si një shtet multietnik i të gjithë qytetarëve të vet dhe i të gjitha komuniteteve të veta. Këto parime janë të rrënjosura fuqishëm në sistemin kushtetues dhe legal të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë pritja kyçe e partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe e sistemit organizativ të komunitetit euro-atlantik, drejt të cilave aspirojmë të gjithë. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, mirëkuptimit dhe bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen në tërësi në jetën fetare të vendit tonë. Lidhur me këtë është bërë mjaft shumë punë, por kjo duhet të forcohet dhe përhapet edhe më tutje, posaçërisht në këtë kohë të tendosjeve të rritura dhe të ngecjes në normalizim. Gjatë viteve, kam vërejtur me një vlerësim të lartë kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në kontekstin e kornizave të ndryshme të dialogut ndërfetar dhe të nismave të ndryshme të bashkëpunimit praktik ndërfetar.

Unë dhe kolegët nga projekti do të donim, edhe t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, edhe t'ju ofrojmë disa sugjerime të reja në këtë drejtim. Kjo do të ishte posaçërisht e rëndësishme në komunën multietnike Gračanica/Graçanicë, krijimi i të cilës është në vetvete produkt i multietnicitetit kushtetues të Kosovës. Thënë përgjithësisht, përdorimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, ose përmbajtje të përbashkëta të mediave sociale, apo vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë apo institucionalë në qendrat dhe vendet e rëndësishme komunitare. Lehtësimi i përfshirjes së respektimit për diversitetin fetar dhe etnik në Predikimet e Xhumasë – e që jam i sigurtë se tashmë është duke ndodhur – do të ishte po ashtu një mënyrë efektive e kontribuimit. Në një mënyrë më konkrete, në disa nga letrat e mia paraprahe kam propozuar krijimin e një këshilli Ndër-Fetar i cili do ta koordinonte dhe këshillonte shtetin dhe donatorët ndërkombëtarë sa i përket mbrojtjes dhe riparimit të vendeve të cënueshme fetare anëmbanë Kosovës. Komuna juaj mund të jetë një vend-pilot ideal për këtë projekt që më pastaj mund të zgjerohet në të tërë Kosovën. Kjo jo vetëm që do ta shtonte mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu do ta rikonfirmonte vazhdimisht mesazhin e Paqes, që është i rrënjosur aq fuqishëm në Besimin Mysliman, si në Kosovë, ashtu edhe anëmbanë botës.

I nderuari Imam, jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i KCA-së, do të jenë të gatshëm që me kënaqësi t'ju ofrojnë përkrahje konkrete për zbatimin e sugjerimeve të dhëna këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Šabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve  
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë  
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Imam Xheladin Fazliu,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe për momentin punoj si Udhëheqës i Hulumtimit në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS – Kosovar Centre for Security Studies). Me formim në studimet e paqes dhe të konflikteve, dhe duke pasur titullin Master nga Universiteti St. Andrews dhe PhD-në nga Dublin City University, unë karrierën time ia kam kushtuar avancimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe me diversitet. Rrugëtimi im profesional ka përfshirë role si aktivist, udhëheqës organizativ, dhe Zëvendës-Ministër për Integrimet Europiane.

Kushtetuta e Kosovës e parasheh një të ardhme ku vendi jonë është i lirë, demokratik, paqedashës, dhe shtëpi për të gjithë qytetarët e vet. Ky vizion është thelbësor për qëllimin tonë të përbashkët që një ditë të bëhemi pjesë e Unionit Europian, dhe është përgjegjësi jona kolektive për ta realizuar këtë vizion.

Bashkësia Islame në Kosovë e luan një rol kyç në promovimin e paqes, të tolerancës dhe të bashkëpunimit ndëretnik. Udhëheqësia juaj mund të frymëzojë përpjekje që e theksojnë respektimin e ndërsjellë, dhe lidhur me këtë, do të doja t'i propozoj tri ide për nxitjen e mëtutjeshme të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë.

Së pari, ju ftoj t'i përkrahni dhe mbështesni përpjekjet dhe aktivitetet e organizuara nga organizatat e shoqërisë civile, si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia, për t'i bërë njerëzit bashkë dhe për ta ofruar një platformë për dialog dhe bashkëpunim. Në klimën e tashme politike midis Kosovës dhe Serbisë, është kyçe që të kemi zëra nga Bashkësia Islame e Kosovës që i përkrahin udhëheqësit e shoqërisë civile dhe veprimtaritë që i promovojnë pajtimin dhe normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve.

E dyta, ju inkurajoj ta merrni një rol proaktiv në promovimin e dialogut ndërfetar. Është e rëndësishme për qytetarët e Kosovës të shohin më shumë shembuj ku ju dhe udhëheqësit e tjerë fetarë takohen dhe japin mesazhe të përbashkëta për të gjithë qytetarët e Kosovës. Do të doja po ashtu t'ju inkurajoj ta shikoni mundësinë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm me udhëheqësit e tjerë fetarë, të tillë si ata nga Kisha Ortodokse Serbe, Bashkësia Katolike, Kisha Protestante, e të tjerë. Ne e kemi një nevojë urgjente që të gjithëve t'ju shohim bashkë sa më shpesh, duke dhënë mesazhe të tolerancës dhe të bashkëpunimit.

E treta, ju inkurajoj që brenda xhamive t'i zbatoni mësimet që e përkrahin bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndëretnik, njësoj si dhe tolerancën. Këto mësimet mund ta luajnë një rol të rëndësishëm në trajtësimin e një shoqërie më përfshirëse dhe më mirëkuptuese në Kosovë. Për shembull, gjatë predikimeve të rregullta të të premtëve, khutbahëve, ta keni ndonjë Khatib mysafir për ta dhënë një ligjëratë në temën e tolerimit.

Ju falemnderit për vëmendjen tuaj për këto çështje.

Sinqerisht,

Ramadan ILAZI



**Dimitrije Obrenović,**  
**Koordinator i Projekteve,**  
**NGO Aktiv**  
**Mitrovica e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam Xheladin Fazliu,

Quhem Dimitrije Obrenović, dhe jam aktivist i të drejtave të njeriut që jeton në Mitrovicën e Veriut. Unë përpiqem për të drejta të barabarta dhe për forcim të bashkëpunimit ndërfaqetare, duke besuar fuqishëm se për një të ardhme më të mirë nevojitet një bashkëpunim i mëtutjeshëm.

Pozita juaj me ndikim në komunitetin mysliman mund të ndihmojë në promovimin e mesazheve të paqes dhe të unitetit. Në të ardhmen pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndërfaqetare dhe të projekteve të shërbimit në komunitet që përfshijnë grupe të ndryshme fetare që punojnë së bashku.

Në këtë frymë, unë shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë do të bëhet normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet etnike dhe fetare merren si anë të forta, jo si burime ndarjesh. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet kulturor dhe tolerancë, që mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve etnike dhe fetare në qeverisjen lokale.

Për këtë arsye ju inkurajoj të merrni pjesë aktive në krijimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës, duke mbështetur nisma ndërfaqetare, duke përkrahur politika që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë, dhe duke nxitur dialogun e hapur dhe me respektim midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

E përfundoj këtë letër me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët, ne mund të arrijmë përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të merituar.

Dimitrije Obrenović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë  
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Prishtinë, Kosovë**

I nderuari Imam Fazliu,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë.

Jam i bindur fuqishëm se ju, si dhe institucionet përkatëse të Bashkësisë Islame në komunën e Graçanicës, mund ta jipni një kontribut të konsiderueshëm dhe domethënës për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, në vendin ku ju jeni aktiv, dhe, në këtë mënyrë, edhe më gjerë në Kosovë. Këtë mund ta bëni thjeshtë duke ndjekur parime thelbësore shumica nga të cilat janë të mbështetura dhe të predikuara edhe nga vetë besimi juaj fetar.

Së pari, në veprimtaritë tuaja fetare dhe shoqërore mund të përqendrohemi sa më shumë në promovimin e mirëkuptimit dhe të respektimit të ndërsjellë midis komuniteteve të Graçanicës. Që të dyja komunitetet kryesore etnike, edhe serbët, edhe shqiptarët, duhet të njihen dhe t'i kuptojnë vështirësitë nëpër të cilat ka kaluar pala tjetër në të kaluarën e vet, ashtu që ato të dyjt ta kenë një pamje të plotë të kompleksitetit të mozaikut etnik kosovar. Kjo, më tutje, mund ta nxisë dialog midis këtyre dy komuniteteve, dhe mund ta hapë rrugën për shfaqjen e respektit të ndërsjellë në të ardhmen.

Së dyti – dhe e ndërlidhur me të parën – një tipar tjetër që mund të forcohet, si në predikimet dhe aktivitetet tuaja, ashtu edhe nga besimtarët tuaj, është ndjeshmëria kulturore dhe fetare ndër zyrtarët fetarë, si dhe nga besimtarët e feve e të etnive të ndryshme. Pranimi i kulturave të tjera, dhe respektimi i tyre – e që është thelbi i multi-kulturalizmit – është një nga tiparet thelbësore të shoqërive më të avancuara.

Ju po ashtu mund të përpiqeni ta promovoni bashkëpunimin me udhëheqës të tjerë fetarë. Konfliktet në Ballkan, dhe në Kosovë, u kanë shkaktuar dëme të mëdha marrëdhënieve normale midis feve kryesore në rajon. Anëmbanë rajonit, pas luftrave, fetë kryesore kanë mbetur në gjendje të armiqësisë dhe të urrejtjes. Në Kosovë kjo është pasqyruar në marrëdhëniet e acaruar midis Kishës Ortodokse Serbe, nga njëra anë, dhe nga tjetra, feve shqiptare, si Islami, Katolicizmi, etj. Gjendja e izolimit në të cilën Kisha Ortodokse Serbe ka mbetur në Kosovë nuk është normale, dhe nuk është e pranueshme. Bashkësia Islame e Kosovës dhe institucionet e saj, në nivele qendrore dhe lokale – si dhe institucionet dhe përfaqësuesit e feve të tjera në Kosovë – duhet të jenë të gatshme dhe të hapura për të bërë gjithçka që është e mundur për ta tejkaluar këtë izolim të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. E vetmja mënyrë për të pritur që serbët do ta pranojnë Kosovën si vend të tyre është që Kosova t'i pranojë serbët si qytetarë të vet – dhe kjo, kuptohet, e nënkupton edhe pranimin e Ortodoksisë Serbe si njëres nga fetë e veta.

Këto janë vetëm disa nga veprimtaritë e shumta që mund të ndërmerren për ta përmirësuar gjendjen e marrëdhënieve dhe të bashkëjetesës ndëretnike në Graçanicë, dhe, më gjerësisht, në Kosovë. E qartë, në takimet që presim t'i kemi me ju në të ardhmen mund të dalin e të diskutohen edhe ide të tjera të shumta.

Ju falemnderit, dhe përshëndetjet më të sinqerta,

Mentor Agani

**Zoran Savič, Koordinator i Projekteve**  
**NGO AKTIV**  
**Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Imam, Xheladin Fazliu,

Quhem Zoran Savič, dhe jam Koordinator i Projekteve në organizatën jo-qeveritare Aktiv nga Mitrovica e Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në fakt kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite me radhë dhe jam përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh që po ashtu jam edhe muzikan, dhe kam marrë pjesë në projekte të ndryshme ndëretnike me muzikanë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për vite të shumta kam punuar si gazetar në portalin Kosovo Sever, KosSev, dhe përmes kësaj pune jam bërë edhe më i afërt me situatën politike, të sigurisë, dhe atë fetare në Kosovë. Madje edhe sot, unë bashkëpunoj me shumë gazetarë dhe redaktorë shqiptarë, si përmes projekteve, ashtu edhe përmes punëve të tjera.

Meqë jeni pjesë e Komunitetit Islamik në Kosovë, ju në një masë të madhe mund ta promovoni harmoninë ndëretnike. Nxitja e dialogut dhe e bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund të ndihmojë në tejkalimin e ndasive. Ju nxis që t'i përkrahni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që do t'i bëjnë bashkë njerëzit e prapavijeve të ndryshme. Predikimet dhe adresimet tuaja publike mund t'i theksojnë unitetin, tolerancën, dhe respektimin e të gjithëve. Prandaj, e pres përkrahjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndëretnike dhe të projekteve të shërbimeve të komunitetit që përfshijnë punën e përbashkët të grupeve të ndryshme fetare.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa fetare multi-etnike do të bëhet normë në Kosovë. Unë parashoh komunitete ku dallimet fetare përqafohen si fuqi, dhe jo si burime të ndarjeve. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohni në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitetin dhe tolerancën fetare, të përkrahni projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe të siguronit përfaqësim të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Këtë letër po e përfundoj me një vërejtje shprese, duke e paraparë një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara e kultivojnë një shoqëri mirëfilli harmonike dhe shumëetnike në Kosovë. Jam i sigurt se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Savič